**REPUBLIKA E KOSOVËS**
**REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA**
**KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË**
**MUNICIPAL ASSEMBLY- SUHAREKË-SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA**

# DRAFT-PLANI PËR NDËRHYRJE NDËR-SEKTORIALE PËR NDRYSHIMET KLIMATIKE 2023-2028

Tetor, 2022

Përkrahur nga:

## Shkurtesat dhe simbolet e përdorura në tekst:

| | |
|---|---|
| VDKZ | Veprimet e duhura kombëtare për zbutje ndaj ndryshimeve klimatike |
| QKZhGj | Qendra Komunale për zhvillim të gjelbër |
| EE | Efiçienca e energjisë |
| BRE | Burimet e ripërtëritshme të energjisë |
| $CO_2$ | Dioksidi i karbonit |
| NVKA | Ngrohje, ventilim dhe kondicionim i ajrit |
| GS | Gazrat serrë (Gazrat që e krijojnë "efektin serrë") |
| ZKE | Zyra komunale për energji |
| MKE | Menaxheri komunal i energjisë |
| UNDP | United Nations Development Programme (Programi për zhvillim i Kombeve të bashkuara) |
| nZEB | Ndërtesat afër zero energji (Near Zero Energy Buildings) |
| PKVEE | Plani komunal i veprimit për efiçiencë të energjisë |
| DKA | Drejtoria komunale e arsimit |
| QMF | Qendra e mjekësisë familjare |
| QKMF | Qendra kryesore e mjekësisë familjare |
| Sh.F.M.U. | Shkolla fillore dhe e mesme e ulët |
| PV | Fotovoltaike |
| FKEE | Fondi i Kosovës për efiçiencë të energjisë |
| ESCO | Kompanitë për shërbime energjetike (Energy Service Companies) |
| LED | Light emitting diode (dioda e emetimit të dritës) |
| PKMM | Plani Komunal për menaxhim mbeturinave |
| MMPHI | Ministria e Mjedisit, Planifikimit hapësinor dhe Infrastrukturës |
| PZHK | Plani zhvillimor komunal |
| HZK | Harta zonale komunale |
| BE | Bashkimi Evropian |
| m | Metër |
| $m^2$ | Metër në katror |
| $m^3$ | Metër në kub |
| $kgCO_2$/vit | Kilogram dioksid karboni për vit |
| ME | Ministria e ekonomisë |
| mil.$m^3$ | Milion metër kub |
| km | Kilometër |
| MBPZhR | Ministria e bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimit rural |
| MTI | Ministria e tregtisë dhe industrisë |
| € | Euro |

# Përmbajtja

1. Hyrje ..... 6
2. Qëllimi ..... 7
3. Metodologjia ..... 7
3.1. Plani i veprimit ..... 7
4. Profili i Komunës së Suharekës ..... 8
4.1. Legjislativi ..... 8
4.2. Ekzekutivi ..... 9
4.3. Ekonomia ..... 9
4.4. Infrastruktura teknike ..... 9
4.5. Infrastruktura publike dhe sociale ..... 9
4.6. Mjedisi dhe ndotja mjedisore ..... 10
4.7. Sipërfaqet me rrezikshmëri ..... 10
4.7.1. Vërshimet ..... 10
4.7.2. Erozioni ..... 11
4.8. Shfrytëzimi aktual i tokës ..... 11
4.9. Kushtet klimatike ..... 11
4.10. Malet dhe luginat ..... 12
4.11. Karakteristikat hidrografike ..... 12
4.12. Asetet e trashëgimisë natyrore ..... 13
4.13. Emetimet e gazrave serrë në Komunën e Suharekës ..... 13
5. Dokumentet ekzistuese të ndërlidhura me hartimin e planit ndër-sektorial ..... 14
6. Analiza e sektorit të energjisë ..... 15
6.1. Konsumi i energjisë në nivel të Kosovës ..... 15
6.2. Konsumi i energjisë në nivel të komunës së Suharekës ..... 16
6.2.1. Ndërtesat publike komunale dhe flota komunale e automjeteve ..... 16
6.2.2. Ndriçimi publik i rrugëve ..... 17
6.3. Ulja e Gazrave Serrë përmes masave të planifikuara dhe të propozuara në sektorin e energjisë ..... 18
6.4. Plani i masave për sektorin e energjisë ..... 19
7. Analiza e sektorit të menaxhimit të mbeturinave ..... 31
7.1. Menaxhimi i mbeturinave në Kosovë ..... 31
7.1.1. Deponimi i mbeturinave komunale ..... 31
7.1.2. Mbulueshmëria me shërbim të mledhjes së mbeturinave komunale ..... 31
7.1.3. Arkëtimi në nivel vendi ..... 32
7.2. Menaxhimi i mbeturinave në Komunën e Suharekës ..... 32

7.2.1. Mbulueshmëria me shërbim të mbeturinave në territorin e Komunës ....... 33
7.2.2. Arkëtimi në Komunën e Suharekës ....... 34
7.2.3. Gjenerimi i mbeturinave në Komunën e Suharekës ....... 34
7.2.4. Deponitë e mbeturinave ....... 34
7.2.5. Ndarja e mbeturinave ....... 35
7.2.6. Zvogëlimi dhe riciklimi i mbeturinave ....... 35
7.3. Ulja e Gazrave Serrë përmes masave të planifikuara dhe të propozuara në sektorin e menaxhimit të mbeturinave ....... 35
7.4. Plani i masave për sektorin e mbeturinave ....... 37
8. Analiza e sektorit të Transportit ....... 43
8.1. Konsumi i produkteve energjetike dhe emetimet në sektorin e transportit në Suharekë ....... 44
8.2. Rreziqet nga ndryshimet klimatike në transport dhe përshtatja ....... 45
8.3. Ulja e Gazrave Serrë përmes masave në sektorin e transportit ....... 45
8.4. Plani i masave në sektorin e transportit ....... 46
9. Analiza e sektorit të Shërbimeve Publike ....... 53
9.1. Trajtimi i shërbimeve publike nga aspekti i ndryshimeve klimatike ....... 53
9.2. Plani i masave në sektorin e shërbimeve publike ....... 55
10. Zhvillimi rural ....... 61
10.1. Veprimet për uljen e emetimit të GS dhe veprimet për përshtatje për sektorin e zhvillimit rural ....... 62
10.2. Plani i masave në sektorin e zhvillimit rural ....... 63
11. Referencat ....... 78
12. Shtojcat ....... 78
12.1. Veprimet e duhura kombëtare te Zbutjes (VDKZ-të) ....... 78
12.2. Grupi Punues ....... 79

## Lista e tabelave


*Tabela 1. Numri i objektivave, masave, veprimeve si dhe kostoja për zbatimin e tyre sipas sektorëve* ........ 7
*Tabela 2. Karakteristikat hapësinore të Komunës* ........ 8
*Tabela 3. Sipërfaqja dhe përqindja e sipërfaqeve të ndërtuara sipas kategorive* ........ 11
*Tabela 4. Vlerat mesatare klimatike* ........ 12
*Tabela 5. Asetet e trashëgimisë natyrore nën mbrojtje* ........ 13
*Tabela 6. Pasqyra e potencialit te kursimeve te energjisë në Komunën e Suharekës* ........ 16
*Tabela 7. Lista e projekteve për investimet prioritare sipas PKVEE* ........ 16
*Tabela 8. Shpenzimet e energjisë në raport me buxhetin komunal për vitin 2017* ........ 16
*Tabela 9. Shpejtësitë mesatare mujore të erës (në m/s) në vende të matura në zonën e Suharekës* ........ 18
*Tabela 10.Shkalla e mbulimit me shërbim të mbledhjes së mbeturinave* ........ 33
*Tabela 11.Pasqyra e përgjithshme e mbulimit me shërbim të mbledhjes dhe transportit të mbeturinave komunale në vitet 2019 dhe 2020,* ........ 33
*Tabela 12.Sasia e mbeturinave komunale të grumbulluara dhe të gjeneruara në Suharekë,* ........ 34
*Tabela 13. Numri i deponive ilegale në Suharekë në vitin 2019/2020* ........ 35
*Tabela 14. Qasja në infrastrukturën për ndarjen e mbeturinave komunale në burim, në vitin 2019,* ........ 35


## Lista e figurave


*Figura 1. Pozita gjeografike e komunës së Suharekës* ........ 8
*Figura 2. Konsumi final i energjisë në Kosovë sipas sektorëve* ........ 15
*Figura 3. Pjesmarrja e burimeve energjetike në konsumin e energjisë në Kosovë në 2021* ........ 15
*Figura 4. Shpenzimet komunale për lëndë djegëse dhe energji elektrike, 2017* ........ 17
*Figura 5. Krahasimi i konsumit mesatar specifik të energjisë për ndërtesat komunale të përzgjedhura në komunën e Suharekës* ........ 17
*Figura 6.Mjetet motorike dhe jo motorike të regjistruara në periudhën 2011-2020* ........ 43
*Figura 7.Tranzicioni i drejtë: pesë fushat e veprimeve për investitorët* ........ 61

# 1. Hyrje

Ndryshimet klimatike në nivelin global janë bërë një nga sfidat më të mëdha të ditëve të sotme dhe kërkimet shkencore kanë treguar se shkaku kryesor është rritja e emetimit të gazrave me efekt serrë të shkaktuar nga djegia e lëndëve djegëse fosile, bujqësia intensive dhe prerja e pyjeve. Ndikimi i ndryshimeve klimatike në një sektor të caktuar dhe cenueshmëria e tij mund të jenëtë ngjashme në disa raste ose në disa vende të ndryshme, por fatkeqësisht nuk ka udhëzime të përgjithshme për përshtaje. Çdo rast është i veçantë dhe secilit rast duhet t'i jepet një zgjidhje individuale - ndryshimet klimatike ndikojnë globalisht, por masat e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike janë padyshim në përputhje me rrethanat lokale të vendit ose territorit të caktuar.Pasojat e ndryshimeve klimatike në shoqëri dhe në proceset sociale janë të ndryshme dhe të gjitha rezultojnë në një rritje të cenueshmërisë së njerëzve dhe sistemeve natyrore. Veprimet për përballjen me ndryshimet klimatike janë të mundura në dy mënyra, që janë,veprimetpër eleminimin ose zvogëlimin e shkaktarëvetë ndryshimeve klimatike, gjegjësisht pengimi apo zbutja e ndryshimeve klimatike, ose veprimet për përshtatje ndaj pasojave të ndryshimeve klimatike, gjegjësisht përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike. Pengimi/zbutja e ndryshimeve klimatike synon të zvogëlojë emetimin e gazeve serrë (GS) dhe/ose të rrisë kapacitetet absorbuese të këtyre gazrave.

Përfshirja e zbutjes dhe përshtatjes efektive dhe të barabartë në planifikimin e zhvillimit mund të zvogëlojë cënueshmërinë, të ruajë dhe të rivendosë ekosistemet dhe të mundësojë zhvillim rezistent ndaj ndryshimeve klimatike. Kjo veçanërisht është sfiduese në lokalitetet me burime të kufizuara njerëzore dhe financiare. Zgjidhjet e integruara dhe gjithëpërfshirëse të orientuara nga sistemi, të bazuara në barazi dhe drejtësi sociale dhe klimatike, ulin shkallën e rreziqeve dhe mundësojnë zhvillim rezistent ndaj ndryshimeve klimatike [1].

Komunat e Kosovës menaxhojnë me territorin e tyre dhe janë përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e planeve zhvillimore lokale. Është veçanërisht e rëndësishme që gjatë hartimit të këtyre planeve, komunat të përfshijnë aspeketet e koordinimit ndërsektorial për trajtimin e ndryshimeve klimatike. Në përputhje me këtë, Komuna e Suharekës me mbështetjen e Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP) është duke zbatuar projektin "Fuqizimi i Veprimit Lokal për Klimën".Projekti ka për qëllimtë përshpejtojë përpjekjet për uljene emetimeve të përgjithshme të gazrave serrë (GS) nëpërmjet ndërhyrjeve ndërsektoriale, duke përfshirë masat për zbutje dhe përshtatje ndaj ndryshimeve klimatike. Komuna e Suharekës e ka themeluar Qendrën Komunale për Zhvillim të Gjelbër, e cila shërben si qendër për planifikim të ndërhyrjeve, projekteve dhe është mbikëqyrëse e Veprimeve të Duhura Kombëtar për Zbutje (VDKZ) komunale. Në të ardhmen kjo do t'i mundësojë komunës së Suharekës definimin e prioriteteve lidhur me klimën dhe veprimet për zbutje.

Përë planifikuar dhe koordinuar ndërhyrjet e përbashkëta për ndryshime klimatike, Plani për ndërhyrje ndër-sektoriale për ndryshimet klimatike 2023-2028 i Komunës së Suharekës i përfshinë sektorët e energjisë, transportit, menaxhimit të mbeturinave, shërbimeve publike dhe zhvillimit rural. Ky plan i përfshinë edhe sygjerimet për zvogëlimin e pabarazive brenda shoqërisë, qoftë pabarazinë gjinore, apo grupet e margjinalizuara. Bazuar në këtë plan, komuna do të mund të përcaktojë portofolin e ndërhyrjeve të detyrueshme dhe të mundshme për të arritur uljen e synuar të emetimeve të GS-ve.

[1] Climate Change 2022, Impacts, Adaptation and Vulnerability; Summary for policy makers

## 2. Qëllimi

Plani ndër-sektorial ka për qëllim të përcaktojë ndërhyrjet nga sektorët relevant për të arritur uljen e synuar të emetimeve të GS-ve për Komunën e Suharekës përmes formulimit përmbledhës të ndërhyrjeve të VDKZ-ve nga sektorët e energjisë, transportit, shërbimeve publike, menaxhimit të mbeturinave dhe zhvillimit rural për të përcaktuar prioritetet e ndërhyrjeve.

## 3. Metodologjia

Për zhvillimin e Planit për ndërhyrje ndër-sektoriale për ndryshimet klimatike (PNNNK) për komunën e Suharekës është ndjekur përafërsisht e njëjta qasje dhe proces që është zbatuar gjatë përpilimit të Planit për ndërhyrje ndër-sektoriale për ndryshimet klimatike për komunën e Prizrenit në vitin 2019, kjo për shkak se PNNNK-ja është i njëjti dokument me rëndësi të njëjtë dhe mbulon sektorët e njëjtë për të dyja komunat. Natyrisht, vizioni i vendimmarrësve, nevojat e njerëzve dhe konteksti i komunave nuk është i njëjtë dhe kjo përfshin cenueshmëritë e ndryshme që komunat kanë ndaj ndryshimeve klimatike të cilat mund të ndryshojnë nga një komunë në tjetrën. Kjo është analizuar dhe PNNNK për Suharekën është në përputhje me rrethanat dhe gjendjen në kontekstin lokal.

Përpara fillimit të konsultimeve dhe diskutimeve me Qendrën Komunale për Zhvillim të Gjelbër (QKZhGj),janë analizuar planet dhe strategjitë ekzistuese sektoriale përkatëse kombëtare dhe komunale që kanë shërbyer si pikënisje për diskutim me QKZhGj. Në Plan janë të përfshira veprimet dhe sygjerimet për rreziqet e mundshme të lidhura me gjininë dhe është siguruar qasja ndërsektorale e përgjegjshme gjinore. Në konsultim të ngushtë me ekipin e projektit të UNDP-së dhe QKZhGj është rënë dakord për sektorët që do të mbulohen në PNNNK, të cilët janë: sektori i energjisë, sektori i menaxhimit të mbeturinave, sektori i transportit, sektori i shërbimeve publike dhe sektori i zhvillimit rural. Secili sektor i komunës është analizuar veçmas dhe është diskutuar me QKZhGj në punëtoritë e mbajtura me 14-15 prill 2022 dhe 31 maj 2022. Bazuar në diskutimet dhe propozimet e dala nga punëtoritë e lartëpërmendura, është përpiluar drafti i Planit të veprimit me projektet të ndara sipas sektorëve. PNNK i përmban projektet e propozuara me detaje si: treguesit e suksesit, institucioni përgjegjës për të zbatuar, periudhën e zbatimit, kostot e investimeve, burimet e financimit, uljene emetimeve të $CO_2$(aty ku ka qenë e mundur të llogaritet) sipas secilit veprim përfshirë edhe prioritetin e zbatimit. Drafti i PNNNK është prezantuar para organizatave të shoqërisë civile(OSHC) dhe sektorit privat në punëtorinë e mbajtur me 20 korrik 2022, ku janë diskutuar projektet e përfshira në draftin PNNNK dhe janë marrë propozime të reja nga pjesëmarrësit, të cilat janë inkorporuar në dokumentin e PNNNK.

### 3.1. Plani i veprimit

Për secilin sektor të analizuar është zhvilluar Plani i masave të veprimit për zbatimin e PNNNK veçmas për secilin sektor. Në tabelën e mëposhtme është përmbledhur numri i objektivave, masave, veprimeve për t'i zbatuar dhe kostoja financiare për zbatimin e të gjitha masave dhe veprimeve.

*Tabela 1. Numri i objektivave, masave, veprimeve si dhe kostoja për zbatimin e tyre sipas sektorëve*

| | Energjia | Menaxhimi i mbeturinave | Shërbimet publike | Transporti | Zhvillimi rural |
|---|---|---|---|---|---|
| Numri i objektivave | 8 | 5 | 5 | 5 | 4 |
| Numri i masave | 11 | 9 | 7 | 10 | 12 |
| Numri i veprimeve | 31 | 21 | 19 | 23 | 51 |
| Kosto për zbatim (€) | 17,334,000,0 | 2,290,000.0 | 42,627,033,0 | 4,256,000,0 | 6,160,000.0 |
| | | | | Kostoja për zbatimin e tërë PNNNK: | 72,667,033.0 |

## 4. Profili i Komunës së Suharekës[2]

Komuna e Suharekës gjendet në pjesën jugore të Kosovës. Kufizohet me komunën e Prizrenit, Mamushës, Rahovecit, Malishevës, Lipjanit, Shtimes, Ferizajt dhe Shtërpcës. Shtrihet në gjerësi gjeografike veriore prej 42°15’ – Parku Nacional “Sharri” (jugu), 42°30’ – Malet e Berishës dhe Javori (veriu). Gjatësia gjeografike lindore: 20°45’- komuna e Rahovecit (perëndim), 21°00’- Malet e Jezercit, Guri i Dellocit (lindje).




*Figura 1. Pozita gjeografike e komunës së Suharekës*

*Tabela 2. Karakteristikat hapësinore të Komunës[3]*

| Sipërfaqja $km^2$ | Numri i banorëve rezident 2011 | Numriibanorëve jo-rezident 2011 | Dendësia (banorë/$km^2$) | Lartësia mesatare mbidetare |
|---|---|---|---|---|
| 361.78 | 59,722 | 28,418 | 165 | 455 m – 1760 m |

Të dhënat në tabelën e sipërme bazohen në regjistrimin e fundit zyrtar të vitit 2011, i cili rezulton se në Komunë jetojnë gjithsejtë 59,722 banorë dhe 9145 ekonomi familjare.

### 4.1. Legjislativi

Asambleja komunale ka 31 anëtarë që vijnë nga pesë(5) subjekte politike dhe një iniciativë qytetare që ka një (1) asambleist. Nga anëtarët e Asamblesë Komunale13 janë gra dhe 18 burra[4]. Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Suharekës është z. Bexhet B. Kuçi.

[2]Planizhillimor komunal Suharekë, 2021-2029
[3]Planizhillimor komunal Suharekë, 2021-2029
[4]https://kk.rks-gov.net/suhareke/asambleistet/

## 4.2. Ekzekutivi

Komuna udhëhiqet nga kryetari i komunës z.Bali Muharremaj, i zgjedhur në mandatin e tij të dytë me 50.36% të votave që në raundin e parë të zgjedhjeve komunale të vitit 2021. Ekzekutivi komunal i ka 10 drejtori. Katër (4) drejtori udhëhiqen nga drejtoresha gra dhe gjashtë (6) drejtori udhëhiqen nga drejtora burra. Drejtoritë që udhëhiqen nga drejtoreshat gra janë: Administrata, Inspekcioni, Kultura dhe Shëndetësi dhe mirëqenie sociale. Drejtoritë që udhëhiqen nga burrat janë: Arsimi, Bujqësia, Financat, Pronë dhe Kadastër, Shërbimet publike, mjedis dhe emergjencë, si dhe Urbanizëm dhe planifikim[5].

## 4.3. Ekonomia[6]

Zhvillimi Ekonomik në Komunën e Suharekës kryesisht bazohet në disa fusha të cilat janë me prioritet për zhvillimin e komunës dhe janë vlerësuar si mundësi e mirë për zhvillim në fusha si: Agrokulturë, Turizëm, Energji dhe Prodhim.

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme karakterizohen me zhvillime të ndryshme të veprimtarive, ndërsa si ndërmarrje të mëdha janë Fabrika e Prodhimit të gomës ”Ballkan”, Fabrika e prodhimit të verës “AgroKosova Holding”, Fabrika për përpunimin e lëkurës ”Solid”, Fabrika për tekstil “Arta-Tex”, Fabrika për përpunimin e produkteve të mishit “Flor-en”, fabrika për përpunimin e pijeve freskuese joalkoolike “Frutex”, dhe një sërë ndërmarrjesh për përpunimin e produkteve të drurit, plastikes, aluminit, metalit, etj.

Një aspekt të rëndësishëm të zhvillimit ekonomik paraqesin Zona Industriale në Shirokë dhe Agro Zona në Samadrexhë si dhe autostrada Morinë-Merdare që praktikisht kalon mes përmes komunës së Suharekës.

## 4.4. Infrastruktura teknike[7]

Si në mbarë Kosovën edhe në territorin e komunës së Suharekës, infrastruktura teknike e rrjedhimisht edhe shërbimet publike që ndërlidhen me të nuk janë në nivel të kënaqshëm të zhvillimit. Kjo çështje është problem sidomos sa i përket nivelit të zhvillimit të infrastrukturës ujore dhe për këtë arsye ka nevojë për përpjekje më të mëdha të shoqërisë që ky problem të zgjidhet apo të zbutet. Komuna e Suharekës ka pozitë më të pafavorshme (pas Malishevës) në Kosovë për burim të sigurt të ujit të pijshëm.

Problem është po ashtu furnizimi jo i mirë me energji elektrike ku rrjeti elektrik në disa pjesë është shumë i amortizuar, tensioni i dobët dhe ka ndërprerjetë furnizimit. Rrjeti rrugor është në gjendje relativisht të mirë ku të gjitha vendbanimet janë të lidhura me rrugë të asfaltuara.

Furnizimi i banorëve të Komunës së Suharekës me ujë të pijshëm, momentalisht përcillet me probleme të mëdha. Me probleme përcillen edhe fshatrat që kanë sistemin e ujësjellësit. Kapaciteti ekzistuese eksploatues i burimeve ujore është 0.17 $m^3/s$, derisa 0.121 $m^3/s$ aktualisht shfrytëzohen për furnizim.

## 4.5. Infrastruktura publike dhe sociale[8]

**Ndërtesat administrative dhe publike** janë të përqendruara në pjesën më të madhe në qytetin e Suharekës, si qendër komunale. Në këtë qytet janë të shtrira institucionet e nivelit komunal si Kuvendi i Komunës, Gjykata Komunale, Zyra Komunale e Punësimit,

[5] https://kk.rks-gov.net/suhareke/
[6] Planizhillimor komunal Suharekë, 2021-2029
[7] Planizhillimor komunal Suharekë, 2021-2029
[8] Planizhillimor komunal Suharekë, 2021-2029

zyra e Postës dhe Telekomit, shërbimet bankare, Stacioni i Autobusëve, Zjarrfikëset dhe Stacioni Policor. Ndërkaq në vendbanimet tjera numri i këtyre institucioneve është tejet i vogël dhe përfshinë disa zyre të vendit dhe ofiqari nëpër disa fshatra, dy zyre postare në Samadrexhe dhe Mushtisht si dhe një stacion policor po ashtu në Mushtisht.

**Shërbimet e administratës publike** ofrohen përmes ndërtesës kryesore komunale në Suharekë dhe 7 bashkësive lokale rurale Suharekë, Mushtisht, Studençan, Duhël, Gjinoc, Nishor, Bukosh, Mohlan dhe, të cilat ofrojnë distanca të shkurta nga vendbanimet të cilat i shërbejnë.

**Arsimi:**Në nivel komunal, procesi arsimor zhvillohet në tri nivele, arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm. Rrjeti i ndërtesave të arsimit përbëhet prej 29 shkollave për Arsimin Fillor dhe të Mesëm të Ultë dhe në 3 shkolla të Arsimit të Mesëm të Lartë, ku përfshihen 11522 nxënës, ndërsa në procesin edukativo-arsimor janë të angazhuar rreth 1000 të punësuar, prej tyre 786 mësimdhënës dhe 38 edukatore si dhe stafi udhëheqës, administrativ dhe mbështetës teknik.

**Shëndetësia:**Shërbimi publik shëndetësor në komunën e Suharekës është i organizuar në tri nivele, në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) në Suharekë, qendra të mjekësisë familjare 6 njësi në Mushtisht, Studenqan, Gjinoc, Duhël, Mohlan dhe Bukosh si dhe ambulanca 5 njësi: në Grejkoc, Samadraxhë, Sopi, Nishor dhe Dobërdolan.

## 4.6. Mjedisi dhe ndotja mjedisore[9]

Në komunën e Suharekës ndotja e mjedisit është evidenteKryesisht ndotja më e madhe bëhet me lëshimin e ujërave të zeza nga kanalizimet e vendbanimeve si dhe nga objektet industriale direkt në lumenj. Gjithashtu hedhja e mbeturinave të ngurta pranë rrugëve dhe lumenjve përbën një problem të madh. Në mes të Reshtanit dhe Neprebishtit në lum bëhet eksploatimi i rërës. Për shkak të nevojave për djegie të drurit për ngrohje të hapësirës por edhe për veprimtari ekonomike pyjet dëmtohen pa rrespektuar kriteret e shfrytëzimit të tyre.

## 4.7. Sipërfaqet me rrezikshmëri

### 4.7.1. Vërshimet

Sipas Planit Zhvillimor Komunal të Suharekës (2020-2028), lumi Toplluha i cili kalon nëpër qytet paraqet rrezik të lartë për qytetar, pasi vite me radhë pas të reshurave të mëdha atmosferike ka dal nga shtrati i tij dhe ka vërshuartokat e në disa raste edhe shtëpitë që kanë qenë përreth. Vërshime ka pasur edhe në disa fshatra si në: Semetisht, Studençan dhe Neprebisht por me një shkallë të rrezikshmërisë më të vogël.

Me rregullimin e kanaleve përcjellës, nga gryka e Dubiqakut dhe përroskave të cilat shkaktonin vërshimenga drejtimi i Biraçit, në drejtim të Lumit Toplluha është bërë një zgjidhje e mirë për evitimin e vërshimeve për Suharekën.

Pasi që lumi Toplluha shumëshpesh vërshonte, në pjesën e tij që kalon nëpër qytet është bërë rregullimi i shtratit të tij. Shtrati i rregulluar është iformës katërkëndëshe. Stomet e tij janë të veshur me gurë. Mirëpo, lumi Toplluha në pozicionin në mes të Suharekës dhe Mamushës (në komunën e Prizrenit), rrezikon që t'i vërshoj sipërfaqet e tokës bujqësore.

[9]Planizhillimor komunal Suharekë, 2021-2029

### 4.7.2. Erozioni

Për sa i përket erozionit, rrëshqitje të theksuara të tokës ka pasur në fshatin Vraniq, ku janë rrezikuar edhe shtëpitë e banimit. Gjithashtu lëvizje erozive të tokës kanë ndodhur edhe në vendin e quajtur “Gradina” në dalje të qytetit përreth rrugës kryesore për në Prizren, ku nga lëvizjet e tokës janë dëmtuar disa shtëpi. Lëvizje erozive të tokës por në masë më të vogël janë shënuar edhe në fshatrat: Vraniq, Peçan, Budakovë dhe Papaz.

Sa i përket pikave me rrezikshmëri potenciale në komunën e Suharekës, në bazë të vlerësimit nga Drejtoria përkatëse në komunë është konstatuar se nuk ekziston asnjë e tillë[10].

## 4.8. Shfrytëzimi aktual i tokës

Territori i Komunës së Suharekës është i dominuar me pjesë kodrinore-malore që mundëson zhvillimin e ekonomisë pyjore, turizmit dhe blegtorisë, ndërsa sipërfaqet e rrafshëta shfrytëzohen për aktivitete tjera bujqësore dhe për ngritjen e vendbanimeve. Komuna e Suharekës, vlerësohet se ka 53.75% tësipërfaqesme tokë Pyjore dhe 41.58% metokë bujqësore. Në vazhdim janë të paraqitura të gjitha shfrytëzimet ekzistuese të territorit të komunës së Suharekës në sipërfaqe për hektar si dhe në përqindje.

*Tabela 3. Sipërfaqja dhe përqindja e sipërfaqeve të ndërtuara sipas kategorive*

| Shfrytëzimi i tokës sipas | Sipërfaqja (ha) | % |
|---|---|---|
| Sipërfaqe ujore | 189.41 | 0.6 |
| Shfrytëzim tjetër/Toke natyrore e cila nuk është nën ndonjë shfrytëzim tjetër ekonomik /Toke natyrore e cila nuk është në funksion tjetër ekonomik | 26.46 | 0.08 |
| Prodhim Tretësor / Shërbim i komunitetit | 220.41 | 0.7 |
| Prodhim dytësor/ Industri e prodhimeve të lehta | 291.86 | 0.92 |
| Prodhim dytësor/Minierë dhe gurore/Miniera dhe gurore tjetër | 124.15 | 0.39 |
| Prodhim Parësor / Bujqësi | 13140.43 | 41.58 |
| Prodhim Tretësor / Shërbim tregtar | 54.22 | 0.17 |
| Prodhim Tretësor / Shërbim kulturor, argëtues dhe rekreativ / Hapësire e hapur rekreative | 26.95 | 0.09 |
| Banim/Banim me funksione të tjera te përputhshme | 315.29 | 1.0 |
| Prodhim Parësor / Pylltari / Pylltari e bazuar në rotacion të mesëm apo të gjatë | 16985.97 | 53.75 |
| Prodhim Tretësor / Shërbim kulturor, argëtues dhe rekreativ / Hapësire e hapur rekreative | 200.09 | 0.63 |
| Rrjetet e transportit, logjistikës dhe Infrastrukturës publike / Rrjetet e transportit | 5.51 | 0.02 |
| Banim / Banim i përhershëm | 2198.63 | 0.06 |

## 4.9. Kushtet klimatike[11]

Temperatura mesatare vjetore e ajrit në Suharekë është 11.6$^{0}$C. Në muajin gusht lajmërohet maksimumi absolut prej 38.2 $^{0}$C. Amplituda absolute është 52.3 $^{0}$C. Komuna e Suharekës gjendet në jug të Kosovës dhe ka klimë kontinentale me ndikim mesdhetar.

[10]Planizhillimor komunal Suharekë, 2021-2029
[11]Planizhillimor komunal Suharekë, 2021-2029

Në vijim janë radhitur vlerat kyçe klimatike:

- Vlerat mesatare relative vjetore e lagështisë në Suharekë është 74.3%. Lagështia më e ulët relative e ajrit në Suharekë është në muajin gusht 63.2%.
- Vlera mesatare e të reshurave në Suharekë është 674.0 mm. Të reshurat më të mëdha janë në muajin tetor ndërsa më të vogla në muajin shkurt dhe janar.
- Të reshurat më të mëdha në Suharekë janë gjatë muajit mars 169.6 mm, ndërsa sasia minimale e të reshurave në këtë territor është 410.0 mm.
- Shpejtësinë mesatare më të madhe e kanë erërat nga jugperëndimi (4.6m/sek) dhe verilindja (3.6m/sek).

*Tabela 4. Vlerat mesatare klimatike*

| | I | II | III | IV | V | VI | VII | VIII | IX | X | XI | XII | Mes. Vjet. |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Temp. max. | 16.4 | 20 | 25.5 | 26.3 | 32.3 | 36.5 | 37 | 38.2 | 35 | 30.2 | 23.8 | 22 | **38.2** |
| Temp. min. | -14.1 | -12.4 | -10.4 | -3 | 1 | 7 | 6 | 6.2 | 1.5 | -1.8 | -9 | -11 | **-14.1** |
| Temp. mes. | 0 | 1.7 | 5.3 | 11.5 | 15.7 | 19.8 | 22.7 | 22.3 | 18.2 | 11.7 | 7.2 | 3.3 | **11.6** |
| Lagështia (%) | 84.5 | 76.6 | 75.4 | 75.0 | 75.0 | 69.4 | 63.6 | 63.2 | 68.1 | 71.8 | 85.7 | 34.2 | **74.3** |
| Shtypja atmosfrike | 954.1 | 949.6 | 938.4 | 942.6 | 948.5 | 950.1 | 948.4 | 948.2 | 948.6 | 948.6 | 948.7 | 948.6 | **947.9** |
| Shpejtësia e erës (m/s) | 1.0 | 1.5 | 2.5 | 2.7 | 1.9 | 2.4 | 2.2 | 1.9 | 1.8 | 1.8 | 2.2 | 2.6 | **2.0** |
| Reshejt - shi | 33.0 | 12.0 | 26.0 | 47.0 | 89.0 | 124.0 | 36.0 | 37.0 | 31.0 | 136.0 | 70.0 | 33.0 | **674.0** |
| Reshjet - borë | 0.4 | 3.9 | 4.2 | 2.1 | 0.3 | 0.1 | 0.4 | 3.9 | 4.2 | 2.1 | 0.3 | 0.1 | **0.4** |

## 4.10. Malet dhe luginat [12]

Komuna e Suharekës është e rrethuar me male të larta dhe atë në veriperëndim me malet e Pagarushës dhe të Temeqinës me lartësi mbidetare prej 796 deri 828 m, në veri me ato të Carralevës 922 deri 1048m, në lindje me malet e Jezercit 1677m (Kryet e Ahishtes) dhe në juglindje me malet e Sharrit (Dera e Pashës) 2092m, ndërsa në perëndim shtrihet në rrafshina (ultësira) e Prizrenit.

Lartësia mesatare mbidetare në komunë është 455 m. Vetë qyteti i Suharekës gjendet në lartësi mbidetare prej 400 m. Sipërfaqja e komunës është 361 km$^2$ që mbulon 3.3% të territorit të Kosovës.

## 4.11. Karakteristikat hidrografike

Komuna e Suharekës ka rrjet të zhvilluar hidrografik, gjegjësisht ka një numër të madh të lumenjve (përroskave) që kalojnë nëpër territorin e komunës.

Lumenjtë e vegjël janë lumenj me tipare karakteristike për përroskat malore apo lumenj të vegjël, me oscilime shumë të mëdha të sasirave të ujit gjatë vitit. Gjatë kohës së thatë në shumicën e këtyre lumenjve ka pak ose nuk ka ujë fare, kurse gjatë kohës me reshje shpesh ndodh që të ketë vërshime lokale.

Të gjithë ujërat burojnë dhe rrjedhin në territorin e komunës përpos disa përroskave si përroska e Carralevës, Topillës dhe lumit të Bllacës që burimin e kanë në territorin e komunës së Suharekës kurse pjesa më madhe e tyre vazhdojnë rrjedhën dhe derdhen në territorin e komunave tjera.

[12]Planizhvillimor komunal Suharekë, 2021-2029

## 4.12. Asetet e trashëgimisë natyrore

Në territorin e komunës ka pasuri të lëndëve të para, të metaleve dhe jometaleve. Minerali i kromit gjendet në disa vende por prania e tij është më e theksuar në zonën midis Mushtishtit dhe Grejkocit. Minerali i hekurit ndodhet në shpatiet veriore të Rusenicës deri nën Rrafshin e Uthullave dhe gjendet pranë serialit të rrasave serpentine. Sa u përket jometaleve, në territorin e komunës së Suharekës ka argjilë, shkëmbinj karbonat dhe rrasa grafitë. Me rëndësi ekonomike janë argjila për përpunimin e tullave dhe shkëmbinjtë karbonit për materiale ndërtimore. Grafitet gjenden në jug të fshatit Mushtisht në kontakt të tercierit dhe të rasave klorite-sericite por depërtimi në thellësi i tyre nuk është hulumtuar. Gjithashtu në Biraq në bazë të hulumtimeve të bëra është gjetur një hapësirë ku mund të bëhet shfrytëzimi i gurit për prodhimin e materialit ndërtimor si bazë për asfalt. Kjo pjesë është 90% në pronësi private.

Trashëgimia natyrore:

- Guri i Dellocit
- Burimi i ujit mineral në Reqan
- Rezervati natyror i Rusenicës
- Parku natyror Rahavan
- Lisi në Bllacë
- Parku Kombëtar i Malit Sharr

Në territorin e Komunës së Suharekës është një pjesë e Parkut kombëtar "Sharri" që është mjaft i pasur me pyje halore.

*Tabela 5. Asetet e trashëgimisë natyrore nën mbrojtje*

| Lokacioni | Kategoria | Sipërfaqja (ha) |
|---|---|---|
| Rusenica | Rezervat i natyrës | 300.00 |
| Malet e Sharrit | Park kombëtar | 39000.00 |
| Rahavane | Peizazh i mbrojtur | - |

Për shkak të rritjes ekonomike është e domosdoshme të bëhet shfrytëzimi racional i resurseve, gjithmonë duke marrëparasysh ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit. Pyjet në komunën e Suharekës, së bashku me biodiversitetin e tyre paraqesin një atraksion të posaçëm.Një pjesë e pyjeve janëpjesë e Maleve të Sharrit, që gjendet në pjesën jug-lindore (në jug të Mushtishtit dhe të Dellocit) dhe përbëjnë 18 % të sipërfaqes që përfshihet në regjion të Prizrenit nga sipërfaqja e përgjithshme e parkut nacional "Sharri".

## 4.13. Emetimet e gazrave serrë në Komunën e Suharekës

Do të plotësohen pas përfundimit të Inventarit të GS për Suharekën.

## 5. Dokumentet ekzistuese të ndërlidhura me hartimin e planit ndër-sektorial

Në nivelin komunal dokumentet dhe strategjitë relevante zhvillimore të shqyrtuara dhe që janë relevante me hartimin e planit ndër-sektorial për ndryshime klimatike janë:

- Plani zhvillimor komunal i Suharekës (PZHK) 2021-2029
- Projekt Harta zonale e komunës së Suharekës (HZK) 2022-2030
- Strategjia për zhvillim ekonomik lokal për komunën e Suharekës (SZHEL) 2022-2027
- Plani Komunal i veprimit për efiçiencën e energjisë (PKVEE) 2019-2021
- Plani Komunal për menaxhimin e mbeturinave 2016-2021, Komuna Suharekë (Draft)

Institucionet kryesore të Kosovës në nivelin qëndror për hartimin e politikave dhe planeve për mjedisin, klimën, dhe efiçiencën e energjisë janë:

- Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës,
- Agjencia për Mbrojtjene Mjedisit të Kosovës,
- Ministria e Ekonomisë,
- Agjencia e Kosovës për Efiçiencë të Energjisë.

Strategjitë dhe planet relevante në nivel vendi janë:

- Plani Kombëtar i Veprimit i Kosovës për Efiçiencë të Energjisë 2010-2018
- Plani Kombëtar i Veprimit i Kosovës për Efiçiencë të Energjisë 2019-2021
- Strategjia për Mbrojtjen e Mjedisit 2013-2022
- Strategjia për Ndryshime Klimatike 2019-2028
- Strategjia e Energjisë 2017-2026
- Strategjia Sektoriale dhe Transportit Multimodal 2015-2025 dhe Plani i Veprimit 5 vjeçar
- Strategjia për Menaxhimin e Mbeturinave 2013-2022

Disa nga ligjet dhe udhëzimet administrative të nxjerra nga MMPH dhe të ndërlidhura me ndryshimet klimatike dhe emetimet e GS:

- Ligji Nr. 04/L-197 2014 - Ligji për kimikate
- Ligji Nr. 04/L-060 2012 - Ligji për mbeturina
- Ligji Nr. 03/L-043 2009 - Ligji për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes
- Ligji Nr. 03/L-025 2009 - Ligji për mbrojtjen e mjedisit
- Ligji Nr. 03/L-214 2010 - Ligj për vlerësimin e ndikimit në mjedis
- Udhëzim Administrativ QRK Nr.19/2013 për qasje në informata për shpenzimin ekonomik të karburanteve dhe emisionin e $CO_2$ të automjeteve të reja personale
- Udhëzim Administrativ QRK Nr.20/2013 për Zbatimin e Mekanizmave Fleksibël për Zhvillim të Pastër
- Udhëzim Administrativ QRK- Nr. 01/2016 për Mekanizmin e Përcjelljes së Emisioneve të Gazrave Serrë,
- Udhëzim Administrativ QRK Nr.16/2013 për substancat që e dëmtojnë shtresën e ozonit dhe gazrat serrë të fluoruara.
- Udhëzim Administrativ (QRK) Nr. 08 /2016 Për Normat e Lejuara të Shkarkimeve në Ajër nga Burimet e Lëvizshme të Ndotjes
- Udhëzimi administrativ(MI) nr. 01-2012 për ndryshimin dhe plotësimin e UA 2008/13, në Nenin 21, mbi kontrollin teknik të automjeteve

– Udhëzimi administrativ (MI) nr. 04/2016 për kontrollin teknik të automjeteve

# 6. Analiza e sektorit të energjisë

## 6.1. Konsumi i energjisë në nivel të Kosovës

Sasia e përgjithëshme e konsumit të energjisë në Kosovë në tre vjetët e fundit (2019, 20120 dhe 2021) ka shënuar një ngritje të lehtë. Në vitin 2020 konsumi ka qenë 1542.85 ktoe apo ngritje prej 2.34% në krahasim me 2019 (1507.52 ktoe), ndërsa në vitin 2021 konsumi ka qenë 1596.4 ktoe apo në krahasim me 2020 ngritja e konsumit të energjisë ka qenë 3.47%.Sasia e konsumit të energjisë sipas sektorëve për vitet2019, 2020 dhe 2021 [13] është dhënë me paraqitje grafike më poshtë:




*Figura 2. Konsumi final i energjisë në Kosovë sipas sektorëve*

Produkti energjetik më i konsumuari gjatë tre vijteve të shqyrtuara ka qenë produkti i derivateve të naftës, në vitin 2021 ka qenë sasinë prej 689.86 ktoe që përbën rreth 43.21% të konsumit total të të gjitha produkteve energjetike, produkti i dytë energjetik më i konsumuari është energjia elektrike në sasi prej 486.56 ktoe, ose rreth 30.48%. pastaj energjia nga biomasa363.34 ktoe, ose me 22.76%. Energjia solare mbetet burimi më i vogël i konsumuar në vlerë prej 0.49 ktoe, apo 0.03%[14].




*Figura 3. Pjesmarrja e burimeve energjetike në konsumin e energjisë në Kosovë në 2021*

[13] Balanca vjetore e energjisë në Kosovë 2019, 2020 dhe 2021. Agjencia e Statistikave të Kosovës
[14] Balanca vjetore e energjisë në Kosovë 2021. Agjencia e Statistikave të Kosovës

## 6.2. Konsumi i energjisë në nivel të komunës së Suharekës

### 6.2.1. Ndërtesat publike komunale dhe flota komunale e automjeteve

Dokumenti komunal i cili e trajton energjinë për Komunën e Suharekës është Plani Komunal i Veprimit për Efiçiencë të Energjisë (PKVEE) 2019-2021. PKVEE jep informacion mbi konsumin e energjisë në stokun e ndërtesave komunale - ndërtesat administrative, arsimore dhe shëndetësore si dhe në sektorin e ndriçimit rrugor dhe për flotën komunale dhe kompanitë publike të bazuara në kufijtë e komunës. Më poshtë janë treguar gjetjet nga PKVEE 2019-2021 të Komunës së Suharekës.Analiza e stokut të ndërtesave komunale dhe shërbimeve të ndriçimit rrugor tregon se potenciali i përgjithshëm i kursimeve të energjisë në Komunën e Suharekës është vlerësuar të jetë 4,809MWh në vit.

*Tabela 6. Pasqyra e potencialit te kursimeve te energjisë në Komunën e Suharekës*

| | **Konsumi i energjisë (2017)** MWh/vit | **Shpenzimet e konsumit të energjisë (2017)** | **Potenciali për kursim** MWh/vit | **Potenciali për kursim** % |
|---|---|---|---|---|
| Sektori i Ndërtesave Komunale | 9,999[15] | € 311,015 | 4,611[16] | 47%[17] |
| Sektori i Ndriçimit Rrugor | 397 | € 31,739 | 198[18] | 50%[19] |
| Flota Komunale e Automjeteve | 1,806 | € 127,476 | - | - |
| Kompanitë Publike në Komunë | NA | NA | - | - |
| **Gjithsej** | **12,202** | **€ 470,231** | **4,809** | |

Në kuadër të PKVEE është krijuar një listë e projekteve të investimeve prioritare që përfshin 5 projekte me një kursim të përgjithshëm të energjisë prej 800 MWh/vit dhe investime të cilat varirojnë prej 371,000 – 552,000 Euro.

*Tabela 7. Lista e projekteve për investimet prioritare sipas PKVEE*

| # | **Emri i objektit** | **Lloji** | **Konsumi (2017)** MWh/vit | **Potenciali i kursimeve** MWh/vit, **(%)** | **Investimet** Euro |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Shkolla Fillore "7 Marsi" | Arsim | 261 | 128 (-49%) | 65,000-115,000 |
| 2 | Shkolla Fillore "Shkendija" | Arsim | 243 | 82 (-34%) | 140,000-200,000 |
| 3 | QKMF Suharekë | Shëndetësi | 715 | 563 (-79%) | 133,000-190,000 |
| 4 | QMF Bukosh | Shëndetësi | 36 | 21 (-58%) | 13,000-19,000 |
| 5 | QMF Mushtisht | Shëndetësi | 28 | ^(-22%) | 20,000-28,000 |
| GJITHËSEJ: | | | **1,284** | **800** | **371,000-552,000** |

Sipas PKVEE, në vitin 2017 shpenzimet për energji në Komunës së Suharekës janë të përmbledhura në tabelën e mëposhtme:

*Tabela 8. Shpenzimet e energjisë në raport me buxhetin komunal për vitin 2017*

| **Komuna e Suharekës** | **2017** |
|---|---|
| Buxheti i përgjithëshëm komunal | € 13,783,632 |
| Faturat e përgjithshme të energjisë | € 470,231 |
| Ndërtesat publike – (përfsh. en. elektrike) | € 311,015 |
| Ndriçimi publik | € 31,739 |
| Automjetet e komunës (karburantet) | € 127,476 |
| Investimet TOTALE për masat e EE | Nuk dihet |

[15]Për të gjitha ndërtesat komunale të raportuara
[16]Kursimipërndërtesatkomunaletëpërfshiranëanalizë (d.m.th. me sipërfaqedhekonsumtëenergjisënjohurdhembi 80 (kWh/m$^2$*vit)
[17]Përqindja e kursimevevetëmpërndërtesatkomunaletëpërfshiranëanalizë
[18]Përpjesën e mbeturtëndriçimitpublikqëendenukkateknologji LED
[19]Krahasuar me konsumin e energjisë së ndriçimit rrugorë që është raportuar se është pa teknologji LED

Komuna e Suharekës ka shpenzuar afërsisht3.4% të buxhetit të saj për të mbuluar kostot e energjisë. Shpenzimet llogariten duke përdorur konsumin e energjisë të raportuar nga komuna dhe çmimet mesatare specifike të karburanteve dhe energjisë elektrike. Shpenzimet e karburantit për flotën komunale janë 127,476 € në vit.




*Figura 4. Shpenzimet komunale për lëndë djegëse dhe energji elektrike, 2017*

PKVEE 2017-2021 ka identifikuar mundësinë e kursimit të energjisë me zbatimin e masave për EE në të gjitha ndërtesat publike komunale (shkollat, ndërtesat e administratës, ndërtesat shëndetësore, ndërtesat e kulturës/sportit). Kursimi i vlerësuar i energjisë është 4,611.46 MWh/vit. Ky kursim gjithsesi pritet të jetë më i madh pasi analiza e bërë në PKVEE bazohet në investimet për EE vetëm në ndërtesat me konsum specifik më të lartë se 80 kWh/m$^2$/vit.




*Figura 5. Krahasimi i konsumit mesatar specifik të energjisë për ndërtesat komunale të përzgjedhura në komunën e Suharekës*

### 6.2.2. Ndriçimi publik i rrugëve

Sipas PKVEE 2019-2021, gjatësia totale e rrjetit të ndriçimit publik në Komunën e Suharekës është raportuar të jetë 26,94 km. Ndriçimi i rrugëve është siguruar për 45 rrugë/seksione në Komunën e Suharekës.Rrjeti elektrik i ndriçimit publik përfshinë583 llamba për ndriçim. Nga kjo total, 100% janë raportuar të jenë të teknologjisë së ndriçimit HID Metal Halide.

Konsumi i energjisë elektrike i sistemit të ndriçimit publik në vitin 2017 është raportuar të jetë rreth 397MWh. Prandaj, sipas PKVEE, duke aplikuar teknologjinë LED për numrin ekzistues të shtyllave të ndriçimit publik, ka mjaft potencial (rreth 50%) për të kursyer energji, ose rreth 198 MWh.

## 6.3. Ulja e Gazrave Serrë përmes masave të planifikuara dhe të propozuara në sektorin e energjisë

Nga analiza e të dhënave të PKVEE të Komunës së Suharekës 2019-2021, duket se ka mjaftë potencial për kursimin e energjisë me zbatimin e masave për EE në ndërtesat publike komunale dhe në ndriçimin publik të rrugëve. Rrjedhimisht kursimi i energjisë nënkupton edhe uljen të emetimeve të GS, sidomos kjo është evidente në ndriçimin publik të rrugëve nga konsumi i energjisë elektrike që prodhohet kryesisht nga termocentralet me linjit të Kosovës. PKVEE 2019-2021, megjithatë nuk jep të dhëna për analiza të detajizuara për potencialin e kursimit të energjisë në ndërtesa dhe ndriçim publik si dhe potencialin e uljen e GS.

Një tjetër mundësi me potencial të madh të kursimit të energjisë dhe uljt të emetimeve të GS është sektori i amvisërisë i cili sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës për vitin 2020 ky sektor në konsumin e përgjithshëm të energjisë në Kosovë merr pjesë me 41%. Megjithëse nuk ka ndonjë studim për Suharekën në lidhje me konsumin e energjisë, ajo nuk duhet të dalloj shumë nga pjesët tjera të vendit.

Një tjetër mundësi e uljessë GS në territorin e Komunës së Suharekës, është ndërtimi i impianteve për gjenerim të energjisë nga BRE. Sipas studimit Vlerësimi i burimeve të erës të kryer në vitin 2010, në territorin e Komunës së Suharekës ka potencial të prodhimit të energjisë nga era dhe atë në dy lokacione:

- **Budakovë** afër Suharekës, e vendosur në një lartësi prej 1,667 m mbi nivelin e detit;
- **Duhël** afër Suharekës, e vendosur në një lartësi prej 858 m mbi nivelin e detit;

*Tabela 9. Shpejtësitë mesatare mujore të erës (në m/s) në vende të matura në zonën e Suharekës* [20]

| | Budakovë [m/s] | Duhël [m/s] |
|---|---|---|
| gusht 2009 | 4.7 | 5.0 |
| shtator 2009 | 5.9 | 4.7 |
| tetor 2009 | 5.8 | 4.3 |
| nëntor 2009 | 7.4 | 2.9 |
| dhjetor 2009 | 9.5 | 5.1 |
| janar 2010 | 9.0 | 5.1 |
| shkurt 2010 | 9.1 | 4.3 |
| mars 2010 | 8.0 | 4.8 |
| prill 2010 | 5.9 | 4.4 |
| maj 2010 | 7.6 | 4.6 |
| qershor 2010 | 5.5 | 3.5 |
| korrik 2010 | 5.0 | 4.4 |
| Mesatarja për 1 vit | 6.95 | 4.43 |

Në Planin e veprimitpër sektorin e energjisë, janë propozuar një numër i masave për uljen e emetimeve të GS që përfshijnë lloje të ndryshme të masave që prej informimit e ngritjes së kapaciteteve dhe deri te propozimet për investime në EE dhe shfrytëzim të BRE.

[20]Vlerësimi i burimeve të erës, NEK Umwelttechnik AG, 2010

## 6.4. Plani i masave për sektorin e energjisë

| Sektori: Energjia | | Indikatorët e suksesit | Institucioni përgjegjës | Sektorët e ndërlidhur | Afati kohor | Kostoja financiare | Burimi i financimit | Ulja e $CO_2$ (ton/vit) | Statusi | Projekt /Plani Sektorial | Prioriteti |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Objektivi 6.1: Informimi dhe vetëdijësimi për ndryshimet klimatike dhe masat kryesore për zbutje nga ndryshimet klimatike** | | | | | | | | | | | |
| **Masa 6.1.1: Edukimi dhe promovimi i efiçencës energjetike dhe informimi mbi efektet e ndryshimeve klimatike për qytetarët** | | | | | | | | | | | |
| 6.1.1.1 | Organizimi i fushatave informuese në shkollat e mesme të territorit të Komunës për ngritjen e efiçencës së energjisë (EE), mundësive të përdorimit të teknologjive të BRE dhe efektet e ndryshimeve klimatike, p.sh. informimi për teknologji inovative për ngrohje (NVKA), masat për EE në ndërtesa, përdorimi i energjisë diellore në ndërtesat e banimit, informimi lidhur me shfrytëzimin e tarifave të lira të energjisë elektrike që ndikon edhe në zbutjen e pikut të shfrytëzimit të energjisë elektrike, etj. | – Përgaditje e programit të fushatës,<br>– Organizimi i aktiviteteve të fushatës në shkolla | – Drejtoria për Shërbime publike, mjedis dhe emergjencë | – Drejtoria për Arsim,<br>– Organizatat e shoqërisë civile. | 2022-2025 | 10,000.00 | – Buxheti komunal | | | Propozi m i ri | |
| 6.1.1.2 | Ngritja e një pike të informacionit ku qytetarët mund të marrin të gjithë informacionin e nevojshëm për mundësitë e kursimit të energjisë duke ngritur EE dhe përdorimin e teknologjive të BRE në sektorin rezidencial, zëvendësimin e sistemeve joefiçiente të ngrohjes dhe ftohjes me sisteme më efiçiente dhe masa të tjera për rritjen e efiçencës energjetike dhe kursimin e energjisë, informimi për teknologji inovative për ngrohje, ftohje dhe kondicionim të ajrit (NVKA). | – Ndërtimi dhe pajisja e pikës informuese për EE dhe BRE | – Drejtoria për Shërbime publike, mjedis dhe emergjencë | – Drejtoria e urbanizmit dhe planifikimit<br>– Drejtoria e administratës<br>– Organizatat e shoqërisë civile,<br>– Sektori privat | 2022-2023 | 20,000.00 | – Buxheti komunal,<br>– Sektori privat përmes okspozimit të teknologjive | | | Propozi m i ri | |
| | | | | | | **30,000.00** | | | | | |
| **Objektivi 6.2: Fuqizimi dhe funksionalizimi i sistemit komunal për menaxhimin e energjisë** | | | | | | | | | | | |
| **Masa 6.2.1: Aplikimi i menaxhimit komunal të energjisë – masat organizative**<br>Ngritja e efiçiencësenergjetikenëndërtesatpublikekomunaledhendriçimpubliktërrugëveduke modeluardhefunksionalizuarSisteminKomunalpërmenaxhimenergjetik. | | | | | | | | | | | |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 6.2.1.1 | – Themelimi i ZKE, apo punësimin ose emërimin e MKE nga stafi ekzistues teknik i Komunës me përshkrim të vendit të punës me orar të plotë në menaxhimin e energjisë, | – Zyra Komunale për Energji e themeluar, ose<br>– Menaxheri Komunal i energjisë i punësuar. | – Kryetari i Komunës<br>– Drejtoria për Shërbime publike, mjedis dhe emergjencë | – Drejtoria e administratës<br>– | 2023-2024 | Masë organizative | | | | Propozi m i ri | |
| 6.2.1.2 | – Trajnimi i stafit të ZKE ose MKE për menaxhimin e energjisë në: përdorimin e softwerit komunal për menaxhim të energjisë i përcaktuar nga ministria përkatëse; përdorimin e Platformës për monitorim, verifikim dhe raportim të kursimeve të energjisë te ministria përkatëse, nga projektet e zbatuara në Komunën e Suharekës; trajnimi themelor për masat për efiçiencë të energjisë në ndërtesa dhe ndriçim. | – Stafi i ZKE, ose Menaxheri Komunal i Energjisë (MKE) i trajnuar për kryerjen e detyrave të punës | – Kryetari i Komunës<br>– Drejtoria për Shërbime publike, mjedis dhe emergjencë | – ZKE<br>– Drejtoria e arsimit<br>– Drejtoria e administratës<br>– Drejtpria e kulturës<br>– Drejtoria për shëndetësi dhe mirëqenie sociale | 2023-2024 | 10,000.00 | – Buxheti komunal | | | Propozi m i ri | |
| 6.2.1.3 | – Krijimi dhe funksionalizimi i skemës organizative hierkarkike për ndërlidhjen dhe komunikimin e MKE me menaxherët e energjisë në të gjitha ndërtesat publike komunale, në lidhje me raportimin mujor për konsumin e energjisë elektrike, energjisë termike dhe ujit në secilën ndërtesë komunale, si dhe raportimin e konsumit mujor për ndriçimin publik të rrugëve. | – Krijimi dhe funksionalizimi i skemës organizative hierkarkike për ndërlidhjen dhe komunikimin e Menaxherit Komunal të energjisë me menaxherët e energjisë në të gjitha ndërtesat publike komunale. | – Kryetari i Komunës<br>– Drejtoria për Shërbime publike, mjedis dhe emergjencë | – Drejtoria e arsimit<br>– Drejtoria e administratës<br>– Drejtpria e kulturës<br>– Drejtoria për shëndetësi dhe mirëqenie sociale | 2023-2024 | Masë organizative | | | | Propozi m i ri | |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | **10,000.00** | | | | | |
| **Masa 6.2.2: Ngritja e kapaciteteve njerëzore teknike dhe planifikuese komunale** | | | | | | | | | | | |
| 6.2.2.1 | Trajnimiistafittekniktëdrejtorivekomunal eqëkanënëmenaxhimndërtesatpublikedh endriçiminpublik, qëpërfshinëstafintekniktë: Drejtorisëpër Shërbime publike, mjedis dhe emergjencë; Drejtorisë së arsimit; Drejtorisë së shëndetësisë, Drejtorisë së administratës dhe Drejtorisë së kulturës. Trajnimi të përfshijë marrjen e njohurive për planifikimin dhe zbatimin e masave për EE në ndërtesa dhe ndriçim; metodat themelore për llogaritjen e kursimeve të energjisë dhe llogaritjen e emetimeve të GS. | – Numri i trajnimeve të organizuara dhe numri i pjesmarrësve në trajnime | – Kryetari i Komunës<br>– Drejtoria për Shërbime publike, mjedis dhe emergjencë | – Drejtoria e arsimit<br>– Drejtoria e administratës<br>– Drejtoria e kulturës<br>– Drejtoria për shëndetësi dhe mirëqenie sociale | 2022-2023 | 10,000.00 | – Buxheti komunal | | | Propozim i ri | |
| 6.2.2.2 | Trajnimiistafitteknik, qëoperojnë me sistemet e ngrohjes (fokistët), ventilimitdhekondicionimittëajritsidhete knologjitë e reja me pompatermikeTrajnimitëjetëpërstafintek nikpërgjegjëstëtëgjithandërtesavepublike komunale. Trajnimitëfokusohetnëmënyrën e operimit me pajisjet, mirëmbajtjen e rregullttëtyre, duke vënëthekstëveçantënëmënyrën e përdorimittëtyre me efiçiencëtëlartë, aspektetmjedisoresidheçështjetqëlidhen me sigurinënëpunëgjatëoperimit me sistemet. | – Numri i trajnimeve të organizuara dhe numri i pjesmarrësve në trajnime | – Kryetari i Komunës<br>– Drejtoria për Shërbime publike, mjedis dhe emergjencë | – Drejtoria e arsimit<br>– Drejtoria e administratës<br>– Drejtoria e kulturës<br>– Drejtoria për shëndetësi dhe mirëqenie sociale | 2022-2023 | 30,000.00 | – Buxheti komunal | | | Propozim i ri | |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 6.2.2.3 | Organizimiivizitavestudimorenëvendet e BE përtëmarrëpërvojat e miralidhur me aplikimin e EE dhepërdorimin e BRE simundësipërzhvillimtëqëndrueshëmkomunal, qëpërfshijnëedheinstrumentetfinanciareqëmundtëpërdorenngaKomunapërinvestime, incentive/subvencione, përfshirjen e investimevengasektoriprivat, etj. | - Praktikat e mira të zbatuara nga përvojat e mira të vendeve të BE | - Kryetari i Komunës<br>- Drejtoria për Shërbime publike, mjedis dhe emergjencë | - Zyra për Zhvillim të Gjelbër | 2022-2023 | 40,000,00 | - Buxheti komunal<br>- Mbështetje nga organizata ndërkombëtare zhvillimore (UNDP, etj.) | | | Propozim i ri | |
| | | | | | | **80,000.00** | | | | | |
| **Objektivi 6.3: Ngritja e EE dhe përdorimi i BRE në ndërtesa publike dhe ulja e GS-ve** | | | | | | | | | | | |
| **Masa 6.3.1: Zbatimi i masave EE në ndërtesat publike** | | | | | | | | | | | |
| 6.3.1.1 | Studimi i fizibilitetit për ndërtesat publike komunale. Studimi të përfshijë: auditimin energjetik, masat për zbatim të EE në mbështjellësin e ndërtesave, ndriçimin e brendshëm dhe të jashtëm të ndërtesave, sistemet NVKA, shfrytëzimin e ujitë të ngrohtë sanitar si dhe ujin e pijshëm, në përputhje me kriteret minimale për performancë energjetike në ndërtesa dhe standardet më të reja duke përfshirë renovimin e ndërtesave publike në standardin nZEB (near zero energy buildings – ndërtesat me afër zero energji), kostot e investimit si dhe periudha e kthimit të investimit e masave për EE. | - Raporti i studimit të fizibilitetit | - Drejtoria për Shërbime publike, mjedis dhe emergjencë | - Drejtoria e urbanizmit dhe planifikimit<br>- Organizatat Administratës,<br>- Drejtoria e Arsimit,<br>- Drejtoria e kulturës | 2022-2023 | 100,000.00 | - Buxheti komunal,<br>- Sektori privat përmes okspozimit të teknologjive | | | Propozim i ri | |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 6.3.1.2 | Auditimi energjetik i ndërtesave publike komunale me prioritet të lartë të renovimit me masa për EE sipas PKVEE 2019-202: Sh.F.M.U. “7 Marsi”,Sh.F.M.U. “Shkëndija”, QKMF në Suharekë, QMF në Bukosh, QMF në Mushtisht.<br>Pjesë e këtij pakete të jenë edhe: SHFMU "Xhavit Sylaj" në Sllapuzhan dhe SHFMU "Kongresi i Manastirit" në Studenqan | – Raporti i auditimit energjetik i cili i përfshin parallogarinë e investimit dhe periudhën e thjeshtë të kthimit të investimit në zbatimin e masave për EE. | – Drejtoria e Arsimit<br>– Drejtoria e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale | – Drejtoria e urbanizmit dhe planifikimit | 2022-2023 | 25,000.00 | – Buxheti komunal,<br>– Fondi i Kosovës për Efiçiencë të Energjisë (FKEE) | | | Propozim i ri | |
| 6.3.1.3 | Zbatimi i masave për EE në ndërtesat publike komunale me prioritet të lartë të renovimit me masa për EE sipas PKVEE 2019-202: Sh.F.M.U. “7 Marsi”,Sh.F.M.U. “Shkëndija”, QKMF në Suharekë, QMF në Bukosh, QMF në Mushtisht, SHFMU " Xhavit Sylaj" në Sllapuzhan dhe SHFMU " Kongresi i Manastirit" në Studenqan. | – Renovimi i ndërtesave me masa për EE | – Drejtoria e Arsimit<br>– Drejtoria e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale | – Drejtoria e urbanizmit dhe planifikimit | 2023-2024 | 600,000.00 | – Buxheti komunal,<br>– FKEE | | | Propozim i ri | |
| 6.3.1.4 | Monitorimi i mirëmbajtjes së rregullt në të gjitha ndërtesat publike komunale të: sistemeve dhe pajisjeve për ngrohje, ventilim, ftohje dhe kondicionim të ajrit (NVKA); sistemeve të brendshme të ujësjellësit dhe ndriçimit të brendshëm e të jashtëm. | – Raportet e monitorimit. | – Drejtoria për Shërbime publike, mjedis dhe emergjencë (deri sa të themelohet ZKE ose të emërohet MKE) | – Drejtoria e urbanizmit dhe planifikimit | 2023-2024 | 0,000.00 | – Buxheti komunal,<br>– FKEE | | | Propozim i ri | |
| | | | | | | **725,000.00** | | | | | |
| **Masa 6.3.2: Promovimi dhe pilotimi i projekteve me përdorimin e BRE në ndërtesa publike komunale** | | | | | | | | | | | |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 6.3.2.1 | Promovimi uljes së GS nga gjenerimi i energjisë elektrike nga BRE në ndërtesat publike komunale përmes kryerjes së Studimeve të fizibilitetit për instalimin e sistemeve diellore në ndërtesat publike komunale dhe identifikimin e projekteve prioritare me fizibilitet më të mirë në ndërtesat e Gjimnazit, Shkollës teknike, Bibliotekës, Shkollat e mesme dhe Muzeu. | – Numri studimeve të fizibilitetit | – Kryetari i Komunës<br>– Drejtoria për Shërbime publike, mjedis dhe emergjencë | – Drejtoria e urbanizmit dhe planifikimit<br>– Organizatat Administratës,<br>– Drejtoria e Arsimit,<br>– Drejtoria e kulturëss<br>– Drejtoria e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale | 2022-2023 | 25,000.00 | – Buxheti komunal<br>– Donatorët | | | Propozim i ri | |
| 6.3.2.2 | Ulja e emetimeve të GS përmes planifikimit dhe zbatimit të projekteve promovuese për gjenerim të energjisë elektrike nga BRE – energjia diellore nga panelet fotovoltaike (PV) në ndërtesat publike të përmendura më lartë, në varësi nga rezultatet e studimit të fizibilitetit. | – Numri i projekteve të zbatura për instalimin e sistemeve diellore PV për gjenerim të energjisë elektrike në ndërtesat publike komunale | – Kryetari i Komunës<br>– Drejtoria për Shërbime publike, mjedis dhe emergjencë | – Drejtoria e urbanizmit dhe planifikimit<br>– Organizatat Administratës,<br>– Drejtoria e Arsimit,<br>– Drejtoria e kulturës<br>– Drejtoria e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale | 2023-2024 | 200,000.00 | – Buxheti komunal<br>– Donatorët | | | Propozim i ri | |
| 6.3.2.3 | Studimi i fizibilitetit për instalimin e sistemeve diellore termike për ngrohjen e ujit sanitar në ndërtesat shëndetësore komunale dhe identifikimin e projekteve prioritare me fizibilitet më të mirë.Në studim do të analizohet edhe mundësia e përdorimit të makinave për lavanderi që furnizohen me ujë të ngrohtë nga sistemi diellor për ngrohjen e ujit sanitar. | – Numri studimeve të fizibilitetit | – Kryetari i Komunës<br>– Drejtoria për Shërbime publike, mjedis dhe emergjencë | – Drejtoria e urbanizmit dhe planifikimit<br>– Drejtoria e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale | 2023-2025 | 8,000.00 | – Buxheti komunal<br>– Donatorët | | | Propozim i ri | |

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 6.3.2.4 | Pilotimi i projektit për furnizim dhe instalim të makinave për lavanderi që furnizohen me ujë të ngrohtë nga sistemi diellor për ngrohjen e ujit sanitar, në bazë të rezultateve të studimit (të përmendur në pikën paraprake). Projekti të përfshijë: planifikimin, instalimin e sistemit diellor për ngrohje të ujit sanitar, furnizimin dhe instalimin e makinave për larje të tekstilit që furnizohen direkt me ujë të ngrohtë nga sistemi diellor termik si dhe trajnimin e punëtorëve që do të operojnë dhe mirëmbajnë sistemin diellor.<br>Ky projekt do të shërbejë si model dhe përvojë për promovimin e mëtejshëm të projekteve të ngjashme në sektorin rezidencial. Kjo do të ndikonte dukshëm në uljene GS për ngrohjen e ujit. | – Zbatimi i pilot projektit | – Kryetari i Komunës<br>– Drejtoria e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale | – Drejtoria e urbanizmit dhe planifikimit<br>– Drejtoria për Shërbime publike, mjedis dhe emergjencë | 2023-2025 | 35,000.00 | – Buxheti komunal<br>– Donatorët | | | Propozim i ri | |
| | | | | | | **268,000.00** | | | | | |
| **Masa 6.3.3: Përdorimi i instrumenteve të ndryshëm financiar për uljen e emetimit të CO2 përmes ngritjes söe EE dhe përdorimin e BRE në ndërtesat komunale** | | | | | | | | | | | |
| 6.3.3.1 | Komuna e Suharekës, të punoj në mobilizimin e fondeve për financim në masat për EE dhe përdorim të BRE në ndërtesat publike komunale.:<br>– Krijimi i Planit investiv në renovimin me zbatimin e masave për EE në ndërtesat publike komunale dhe ndriçimin publik,<br>– të bashkëpunojë me FKEE për investime në masat për EE në ndërtesat komunale dhe ndriçim publik,<br>– përdorimi i instrumenteve ndërkombëtare financiare,<br>– pëdorimin e investimeve private përmes modelit të ESCO. Në këtë rast duhet ndjekur me saktësi aspektin legjislativ që rrjedh nga Ligji për EE i Kosovës. | – Zbatimi i pilot projektit | – Kryetari i Komunës<br>– Drejtoria e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale | – Drejtoria e urbanizmit dhe planifikimit<br>– Drejtoria për Shërbime publike, mjedis dhe emergjencë | 2023-2025 | Janë masa organizative | | | | Propozim i ri | |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Objektivi 6.4: Ulja e konsumit të energjisë në ndërtesat e banimit përmes promovimit të masave për EE dhe uljen e emetimit të GS** | | | | | | | | | | | |
| **Masa 6.4.1: Renovimi i ndërtesave të banimit duke aplikuar masat për EE** | | | | | | | | | | | |
| 6.4.1.1 | Ulja e emetimeve të GS në sektorin rezidencial përmes zbatimit të kritereve minimale për performacë të energjisë në ndërtesat e reja në rastin e aplikimit të lejeve ndërtimore për ndërtesat e reja | – Numri i lejeve të ndërtimit | – Drejtoria e urbanizmit dhe planifikimit | – Drejtoria e inspeksionit | 2023-2030 | Masë organizative | | | | Propozim i ri | |
| 6.4.1.2 | Krijimi i Rregullores Komunale për:<br>1. subvencionimin e renovimit të ndërtesave ekzistuese rezidenciale duke zbatuar masat për EE, dhe<br>2. subvencionimin e ndërtesave të reja të cilat ndërtohen me standarde më të larta se kriteret minimale (në këtë rast, subvencionimi mund të jetë edhe në formën e zbritjes së taksave komunale për ato ndërtesa për një periudhë të caktuar kohore). | – Numri i subvencioneve komunale të ndara | – Drejtoria e urbanizmit dhe planifikimit | – Drejtoria e inspeksionit | 2023-2024 | Masë organizative | | | | Propozim i ri | |
| 6.4.1.3 | Subvencionimi i renovimit të ndërtesave ekzistuese rezidenciale duke zbatuar masat për EE, dhe subvencionimin e ndërtesave të reja të cilat ndërtohen me standarde më të larta se kriteret minimale | – Numri i subvencioneve komunale të ndara | – Drejtoria e urbanizmit dhe planifikimit | – Drejtoria e inspeksionit | 2024-2030 | 500,000.00 | – Buxheti komunal<br>– Qeveria e Kosovës<br>– Donatorë | | | Propozim i ri | |
| 6.4.1.4 | Ulja e emetimeve të GS në sektorin rezidencial në ndërtesat shumë-banesore ekzistuese në ndriçim me instalimin e ndriçimit me senzor automatik të prezencës në hyrje dhe korridore të ndërtesave, nga ana e Komunës së Suharekës në bashkë-financim me banorët. | – Numri trupave ndriçues dhe llambave me senzor të prezencës të instaluara | – Drejtoria për Shërbime publike, mjedis dhe emergjencë | – Drejtoria e urbanizmit dhe planifikimit | 2023-2024 | 15,000.00 | – Buxheti komunal | | | Propozim i ri | |
| | | | | | | **515,000.00** | | | | | |
| **Objektivi 6.5: Ulja e emetimeve të GS përmes promovimit të përdorimit të BRE në ndërtesat rezidenciale dhe afariste** | | | | | | | | | | | |
| **Masa 6.5.1: Rregulloret për avancimin e përdorimit të masave EE, për instalimin e sistemeve diellore PV dhe sistemeve diellore termike për ngrohjen e ujit sanitar** | | | | | | | | | | | |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Komuna mund të krijoj Rregullore për masa mbështetëse stimuluese të ndryshme për të rritur incentivat për investime në masat për EE dhe përdorimin e BRE në sektorin rezidencial dha atë afarist. Mbështetja e Komunës mund të jetë në formë të subvencioneve me bashkëfinancim të një përqindje të caktuar të investimit, përmes të cilit do të shkurtohet periudha e kthimit të investimit për përfituesin privat dhe do të krijojë incentivë në investim. Lidhur me këtë, Komuna mund të krijoj një plan të mbështetjes me subvencione nga buxheti vetanak. Për rritjen e këtij fondi, Komuna duhet të hulumtoj mundësitë e mbështetjes nga donatorë të ndryshëm, ose të përgadis propozim-projekte për aplikim në fonde të ndryshme që mbështeten nga BE, shtete të caktuara donatore, si dhe instrumente të ndryshme financiare ndërkombëtare., duhke përfshirë edhe kreditë e buta për financim. | | | | | | | | | | | |
| 6.5.1.1 | Studimi dhe analizimi i modeleve të ndryshme të subvencionimit të sektorit rezidencial dhe atij afarist, nga ana e Komunës, në investim për masat për EE dhe përdorim të BRE. | – Raporti i studimit | – Drejtoria për Shërbime publike, mjedis dhe emergjencë<br>– ZKE ose MKE | – Drejtoria e urbanizmit dhe planifikimit | 2023-2025 | 10,000.00 | – Qeveria e Kosovës<br>– Buxheti komunal<br>– Donatorët | | | Propozim i ri | |
| 6.5.1.2 | Krijimi i Rregullores Komunale për subvencionimin e sektorit rezidencial, ndërtesave shumëbanesore dhe atij afarist për përdorimin e BRE në ndërtesa (sistemet diellore për ngrohjen e ujit, sistemet diellore PV dhe pompat termike për ngrohje të hapësirës). | – Dokumenti i Rregullores | – Drejtoria për Shërbime publike, mjedis dhe emergjencë<br>– ZKE ose MKE | – Drejtoria e urbanizmit dhe planifikimit | 2023-2025 | Nuk ka kosto | – Qeveria e Kosovës<br>– Buxheti komunal<br>– Donatorët | | | Propozim i ri | |
| 6.5.1.3 | Subvencionimi i sektorit rezidencial, ndërtesave shumëbanesore dhe atij afarist për instalimin e sistemeve nga BRE në ndërtesa (sistemet diellore për ngrohjen e ujit, sistemet diellore PV dhe pompat termike për ngrohje të hapësirës). | – Dokumenti i Rregullores | – Drejtoria për Shërbime publike, mjedis dhe emergjencë<br>– ZKE ose MKE | – Drejtoria e urbanizmit dhe planifikimit | 2024-2030 | 300,000.00 | – Buxheti komunal<br>– Qeveria e Kosovës<br>– Donatorët | | | Propozim i ri | |
| | | | | | | **310,000.00** | | | | | |
| **Objektivi 6.6: Ulja e emetimeve GS dhe konsumit të energjisë për ngrohje** | | | | | | | | | | | |
| **Masa 6.6.1: Ndërtimi i sistemit për ngrohjen në distancë për qytetin Suharekës** | | | | | | | | | | | |

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 6.6.1.1 | Studimi i fizibilitetit për ndërtimin e sistemit të ngrohjes në distancë për qytetin e Suharekës. Studimi duhet të merr parasysh ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese të ngrohjes nga BRE duke studijuar burimet e ndryshme sikur që janë: përdorimi i enegjisë diellore, energjisë nga biomasa drusore me ashkla. Gjithashtu studimi duhet të merr në konsideratë përdorimin e decentralizuar të pompave termike me koeficient më të lartë të performancës. | - Dokumenti i detalizuar i studimit me skenarët e mundshëm për investim | - Kryetari i Komunës<br>- Drejtoria për Shërbime publike, mjedis dhe emergjencë | - Drejtoria e urbanizmit dhe planifikimit<br>- Drejtoria për pronë dhe kadastër | 2023-2025 | 150,000.00 | - Buxheti komunal | | | Propozim i ri | | |
| 6.6.1.2 | Ndërtimi i sistemit për ngrohjen në distancë për qytetin e Suharekës bazuar në studimin e fizibilitetit të kryer paraprakisht | - Investimi në ndërtimin e sistemit për ngrohje në distancë | - Kryetari i Komunës<br>- Drejtoria për Shërbime publike, mjedis dhe emergjencë | - Drejtoria e urbanizmit dhe planifikimit<br>- Drejtoria për pronë dhe kadastër<br>- Drejtoritë dhe sektorët tjerë komunal sipas nevojës | 2026-2030 | 15,000,000.00 | - Buxheti komunal<br>- Qeveria e Kosovës<br>- Kredi afatgjatë nga instrument të ndryshëm financiar<br>- Donatorë | | | Propozim i ri | | |
| | | | | | | **15,150,000.00** | | | | | | |

**Objektivi 6.7: Ulja e emetimeve GS dhe konsumit të energjisë për ndriçim publik**

**Masa 6.7.1: Zbatimi i masave për EE në ndriçimin publik të rrugëve me aplikimin e teknologjisë LED**

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 6.7.1.1 | Studimi i fizibilitetit për ngritjen e efiçiencës energjetike në ndriçimin publik të rrugëve në tërë territorin e komunës.<br>Ky studim të përfshijë:<br>Auditimi enegjetik të ndriçimit publik ekzistues të rrugëve, propozimet për masat e EE në ndriçim, llogaritjen e shpenzimit të energjisë në gjendjen ekzistuese dhe në gjendjen pas masave të EE sipas skenarëve të ndryshëm të investimit. Skenarët mund të jenë: investimi për implementim të masave për EE në të gjithë ndriçimin ekzistues, në principin e krijimit të "ndriçimit të mençur"; investimi gradual në principin e krijimit të "ndriçimit të mençur"; si dhe investimi i thjeshtë në zëvendësimin e llambave ekzistuese jo-efiçiente me llambat efiçiente të teknologjisë LED. | - Raporti i detalizuar i Studimit të fizibilitetit me skenarët për investim | - Drejtoria për Shërbime publike, mjedis dhe emergjencë | | 2023-2024 | 25,000.00 | - Buxheti komunal | | | Propozim i ri | |
| 6.7.1.2 | Zbatimi i masave për EE në ndriçimin publik të rrugëve në tërë territorin e komunës në varësi të skenarëve të përzgjedhur nga Komuna për investim | - Projektet e zbatuara me masat për EE në ndriçimin publik | - Drejtoria për Shërbime publike, mjedis dhe emergjencë | | 2024-2026 | 500,000.00 | - Buxheti komunal | | | Propozim i ri | |
| 6.7.1.3 | Aplikimi i teknologjisë LED në rastet e instalimit të ndriçimit publik të ri në rrugët e tërë territorit të komunës. | - Numri i projekteve të zbatuara me aplikimin e teknologjisë LED | - Drejtoria për Shërbime publike, mjedis dhe emergjencë | | 2023-2030- | | - Buxheti komunal | | | Propozim i ri | |
| | | | | | | **525,000.00** | | | | | |
| **Objektivi 6.8.8: Ngritja e EE dhe përdorimi i BRE në sektorin e biznesit** | | | | | | | | | | | |
| **Masa 6.8.1: Informimi mbi mundësitë e përfitimeve nga ngritja e EE dhe përdorimit të BRE në sektorin e biznesit** | | | | | | | | | | | |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 6.8.1.1 | – Organizimi i sesioneve informuese në bashkëpunim me Qendrën e biznesit në Suhareke (QBS) për informimin e bizneseve në **Zonën industriale** dhe **Agro-Zonës** lidhur me mundësitë e përfitimeve nga ngritja e EE dhe përdorimi i BRE. | – Numri i takimeve me bizneset<br>– Numri i bizneseve që kanë zbatuar masat për EE | – Drejtoria për Shërbime publike, mjedis dhe emergjencë<br>– Drejtoria e urbanizmit dhe planifikimit | – Drejtoria për pronë dhe kadastër<br>– Qendra e biznesit në Suhareke | 2023-2030 | Masë organizative | – | | | Propozim i ri | |
| 6.8.1.2 | – Hartimi i kritereve për shqyrtim me prioritet aplikimet e kompanive me projekte për ndërtimin e kapaciteteve për gjenerim të energjisë nga BRE. Kjo sidomos ka të bëj me përshpejtimin e procedurave që lidhen me caktimin e lokacionit për ndërtim, përgaditje e dokumentacionit të pronësisë dhe kërkesat për ndryshim të përdorimit të tokës. | – Numri i bizneseve që përdorin BRE në procesin e tyre punues<br>Numri i bizneseve që kanë marrë Lejen nga ZRRE për gjenerim të energjisë elektrike nga BRE | – Drejtoria e urbanizmit dhe planifikimit | – Drejtoria për pronë dhe kadastër<br>– Drejtoria për Shërbime publike, mjedis dhe emergjencë | 2023-2030 | Masë organizative | – Buxheti komunal | | | Propozim i ri | |
| | | | | | | | | | | | |
| **Kostoja e përgjithshme e vlerësuar e investimit për Sektorin e Energjisë:** | | | | | | **17,334.000.00** | | | | | |

# 7. Analiza e sektorit të menaxhimit të mbeturinave

## 7.1. Menaxhimi i mbeturinave në Kosovë

Në Kosovë, menaxhimi i mbeturinave bazohet në Ligjin për mbeturina nr. 04/L- 060. Në bazë të këtij ligji dhe udhëzimet administrative përkatëse rregullohen detyrimet e monitorimit dhe raportimit të të gjithë akterëve në këtë sektor. Në nivel vendi duket se ka një aktivizim më të madh të akterëve të menaxhimit të mbeturinave përmes ndërmarrjes së iniciativave. Por, pa zbatimin e plotë të bazës ligjore, investimeve dhe projekteve konkrete është e vështirë të shihen rezultate të përmirësimit të gjendjes. Megjithëse ka një përmirësim të treguesve, në Kosovë mbetet problematike vazhdimi i deponimit të pjesës dërmuese të mbeturinave ndërsa nuk ka iniciativa të mirëfillta për një ekonomi qarkore. Sasia e mbeturinave të grumbulluara në 2019 është për 2.19% më e madhe krahasuar me vitin paraprak, ndërsa sasia e mbeturinave të grumbulluara në 2020 është 446,332.36 ton/vit, me një rënie prej 3,549 ton apo rreth 1% më pak mbeturina të deponuara se në vitin 2019[21].

Sasia e gjenerimit të mbeturinave në nivel të Kosovës, për kokë banori, mund të llogaritet se e ka normën që rezulton 0.74 kg/banorë/ditë, apo 269.18 kg/banorë/vit. Mbeturinat komunale në vitin 2020 në nivel vendi kanë qenë 480,648.62 ton/vit. Kur krahasohet sasia e mbeturinave të gjeneruara 480,648.62 ton/vit me sasinë e mbeturinave të deponuara që janë 446,332.36 ton, shihet se ka një shmangie prej 34,316 ton mbeturina që nuk kanë përfunduar në deponi. Supozimi është që sasi e mbeturinave është marrë nga mbledhësit e sektori joformal, kurse një pjesë ka përfunduar nëpër pika ilegale të grumbullimit (deponi ilegale).

### 7.1.1. Deponimi i mbeturinave komunale

Menaxhimi i deponive dhe deponimi përfundimtar i mbeturinave në Kosovë bëhet nga Kompania për menaxhimin e deponive të Kosovës (KMDK). KMDK menaxhon deponitë dhe stacionet e transferit dhe ka gjithsej nën menaxhim 4 deponi në: Prizren, Gjilan, Prishtinë dhe Podujevë dhe një stacion të transferit në Ferizaj. Sasia e mbeturinave të deponuara në deponitë sanitare që menaxhohen nga KMDK-ja për vitin 2019 është 340,790.98 ton/vit. Ndërkaq, deponitë e tjera sanitare menaxhohen nga Kompanitë rajonale të mbeturinave (KRM). Sasia e mbeturinave të deponuara nga KRM-të është rreth 105,541.38ton/vit. Kështu, sasia e deponuar e mbeturinave komunale në deponitë sanitare shkon në 446,332.36 ton/vit, me rënie prej 3,549 ton. Këtu nuk është përfshirë sasia e mbeturinave të deponuara në deponitë tjera josanitare, si ajo në Istog (Tuqep), apo në deponitë tjera në pjesën veriore të Kosovës, pasi nuk ka të dhëna të raportuara.

### 7.1.2. Mbulueshmëria me shërbim të mledhjes së mbeturinave komunale

Mbulimi me shërbim të mbledhjes së mbeturinave komunale për ekonomitë familjare ka shënuar ngritje. Sipas të dhënave të raportuara nga Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, janë 5 komuna që tashmë kanë arritur shkallën e mbulimit me shërbim në 100%. Mbulimi me shërbimin e mbledhjes së mbeturinave komunale për 2019 ka qenë 78.5% që tregon një rritje prej 2.9% në krahasim me vitin paraprak[22], ndërsa

[21] Raport i menaxhimit të mbeturinave komunale në Kosovë. Agjencia për mbrojtjen e mjedisit të Kosovës. Viti raportues 2020

[22] Raport i menaxhimit të mbeturinave komunale në Kosovë. Agjencia për mbrojtjen e mjedisit të Kosovës. Viti raportues 2019

mbulueshmëria në fund të 2020 ishte 85.3% në nivel vendi, me një rritje prej 7% (saktësisht 6.8%) të mbulueshërisë në krahasim me 2019[23].
Kategori tjetër për të cilat komunat kanë raportuar mbulimin me shërbim janë bizneset dhe institucionet. Bazuar në këto të dhëna, mbulimi me shërbim për biznese deri në fund të vitit 2020 ka qenë 53.7%, ndërsa për institucione 84.5%. Në këtë shifër duhet patur rezerva pasi shumë komuna nuk kanë arritur të bëjnë filtrimin e bizneseve aktive, përkatësisht atyre që pranojnë shërbimin e mbledhjes së mbeturinave. Kështu, numri i bizneseve mund t'i paraqesë të gjitha bizneset e regjistruara brenda territorit të komunës, dhe rrjedhimisht mbulimi me shërbim supozohet të jetë shumë më i ulët sesa është paraqitu në raport.

### 7.1.3. Arkëtimi në nivel vendi

Shkalla e arkëtimit në vitin 2018 ishte 76.64%, ndërsa ka shënuar ngritje deri në fund të vitit 2019 për 13.76% dhe ka arritur në 90.4% në nivel vendi. Në vitin 2020 shkalla e raportuar arkëtimit për ekonomi familjare ka arritur në 90.84% me një rritje prej 0.5% prej vitit 2019. Për biznese ka arritur në 79.30% dhe për institucione 93.51%.
Megjithë këtë ngritje të përmendur, duhet patur parasysh se operatorët nuk kanë arritur të bëjnë dallimin në mes të arkëtimit nga faturimi për vitin përkatës dhe viteve të kaluara (borxhet e vjetra). Andaj duhet kuptuar se shkalla e arkëtimit është më e ulët se ajo e paraqitur më lartë dhe se raportimi i arkëtimit nuk reflekton domosdoshmërisht rritje të dukshme të faturimit për vitin përkatës raportues. Për 2020, rajoni me shkallën më të lartë të raportimit të arkëtimit është Rajoni i Mitrovicës me 97.10% dhe rajoni i Prizrenit me 92%. Shkalla më e ulët e arkëtimit është në rajonin e Gjakovës me 89.3%[24]

## 7.2. Menaxhimi i mbeturinave në Komunën e Suharekës

Menaxhimi i mbeturinave në Komunën e Suharekës është i rregulluar me Rregulloren komunale për menaxhimin e mbeturinave të territorin e Suharekës e vitit 2020. Gjithashtu është i draftuar edhe Plani Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave 2016 – 2021 për Suharekë.
**Rregullorja për menaxhimin e mbeturinave në territorin e Suharekës 2020**, pëcakton llojin e mbeturinave që i menaxhon komuna, të cilat janë [25]:

- Mbeturinat komunale (amvisërisë dhe të tjera të ngjashme nga përbërja)
- Mbeturinat inerte që nuk treten ose zbërthehen apo reagojnë kimikisht
- Mbeturinat e vëllimshme (pajisjet e amvisërisë dhe mobiljet)
- Mbeturinat nga konstruktim-demolimet
- Bio-mbeturinat
- Mbeturinat komerciale (nga objektet që përdoren për qëllime të tregut, biznesit, sportit, etj.)
- Mbeturinat industriale
- Mbeturinat medicinale
- Mbeturinat shtazore

Komuna nuk i menaxhon:

[23] Raport i menaxhimit të mbeturinave komunale në Kosovë. Agjencia për mbrojtjen e mjedisit të Kosovës. Viti raportues 2020
[24] Raport i menaxhimit të mbeturinave komunale në Kosovë. Agjencia për mbrojtjen e mjedisit të Kosovës. Viti raportues 2020
[25] Rregullore për menaxhimin e mbeturinave në territorin e Suharekës, 2020

– mbeturinat e rrezikshme dhe
– mbeturinat nga llumi/balta e të ngjashme.

Në mes tjerash, Rregullorja parasheh obligime për Komunën, në:

– Krijimin e sistemit të qëndrueshëm për menaxhimin e mbeturinave të ngurrta komunale
– Monitorimin mjedisor te deponisë së mbeturinave
– Identifikimin e pikave ilegale (të zeza) të hedhjes së mbeturinave dhe evitimin e tyre
– Promovimi i minimizimit të mbeturinave (kompostimit shtëpiak etj)
– Promovimi i ngritjes së vetëdijësimit publik – pjesëmarrja aktive e qytetarëve në implementimin e menaxhimit të mbeturinave të ngurrta.

**Plani Komunal (draft) për Menaxhimin e Mbeturinave 2016 – 2021** - i ka të identifikuara deponitë ilegale. Të evidentuara janë 38 lokacione me sipërfaqe prej 16 ha që kanë ekzistuar në vitin 2016. Komuna ka planifikuar që përmes zgjerimit të zonës së shërbimit dhe fushatave të vetëdijesimit të ndikojë në zvogëlimin e këtij numri të deponive ilegale (pikave ilegale të grumbullimit të mbeturinave). Ne vitin 2022 ne teritorin e komunes se suharekes janë të raportuar afro 62 deponi ilegale.

### 7.2.1. Mbulueshmëria me shërbim të mbeturinave në territorin e Komunës

Sipas Planit Komunal 2016-2021, grumbullimi është i shtrirë në 31 vendbanime të Komunës [26]:

– 17 vendbanimeve iu ofrohet shërbimi nga kompania rajonale "Eko Regjioni",
– 14 vendbanimeve iu ofrohet ky shërbim nga kompania private "IS Company".
– Në 10 vendbanime të zonës rurale nuk ka shërbim për grumbullimin e mbeturinave.

Sipas autoriteteve komunale, prej vitit 2020 Komuna e ka autorizuar kompaninë rajonale "Eko Regjioni", në tërësi të territorit te saj. Janë përfshirë 100% te territorit, ndërsa 92.2 % janë për ekonomi familjare.

*Tabela 10.Shkalla e mbulimit me shërbim të mbledhjes së mbeturinave[27]*

| Komuna | Shkalla e mbulimit me shërbim për ekonomi familjare (2018) [28] | Shkalla e mbulimit me shërbim për ekonomi familjare (2019) | Shkalla e mbulimit me shërbim për ekonomi familjare (2020) | Rritja ose zbritja e shkallës së mbulimit për ekonomi familjare 2019 -2020 (%) | Shkalla e mbulimit me shërbim për biznese (2020) | Shkalla e mbulimit me shërbim për institucione (2020) |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Suharekë** | **62.1 %** | **92.2 %** | **80.0 %** | **-12.2 %** | **25.1 %** | **64.1 %** |

*Tabela 11.Pasqyra e përgjithshme e mbulimit me shërbim të mbledhjes dhe transportit të mbeturinave komunale në vitet 2019 dhe 2020,* [29]

[26]Plani Komunal për Menaxhimin e mbeturinave 2016-2021, Komuna e Suharekës. Janar 2016
[27] Raport i menaxhimit të mbeturinave komunale në Kosovë. Agjencia për mbrojtjen e mjedisit të Kosovës. Viti raportues 2020 (Shtojca 2.1)
[28] Raport i menaxhimit të mbeturinave komunale në Kosovë. Agjencia për mbrojtjen e mjedisit të Kosovës. Viti raportues 2019
[29] Raport i menaxhimit të mbeturinave komunale në Kosovë. Agjencia për mbrojtjen e mjedisit të Kosovës. Viti raportues 2020, (Shtojca 2)

| Komuna | Numri i banorëve (ASK-2011) | Numri i ekonomive familjare (ASK-2011) | Numri i bizneseve aktive në komunë 2020 | Numri i institucioneve në komunë 2020 | Numri i ekonomive familjare që pranojnë shërbimin (2019) | Numri i ekonomive familjare që pranojnë shërbimin (2020) | Numri i bizneseve që pranojnë shërbimin (2020) | Numri i institucioneve që pranojnë shërbimin (2019) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Suharekë** | **59722** | **9145** | **2738** | **64** | **8,431** | **7,316** | **686** | **41** |

### 7.2.2. Arkëtimi në Komunën e Suharekës

Sipas Raportit të AKMM për menaxhimin e mbeturinave në Kosovë për vitet 2019 dhe 2020, shkalla e arkëtimit në Komunën e Suharekës për vitin 2018 ka qenë 88.93 %, ndërsa ka patur një ngritje të madhe në vitin 2019 dhe ka arritur në 101.27 % dhe në vitin 2020 është raportuar të jetë 94.86%.
Megjithatë kur flitet për rritjen e arkëtimit duhet patur parasysh atë çka është thënë në pikën 7.1.3 të këtij dokumenti lidhur me dallimin që operatorët duhet të bëjnë nga arkëtimi i borgjeve paraprake (të viteve të kaluara) dhe arkëtimin real për vitin raportues.

### 7.2.3. Gjenerimi i mbeturinave në Komunën e Suharekës

Gjenerimi i mbeturinave për kokë banori i raportuar për 2020 është 0.47 kg për banor/ditë. Të dhënat tjera lidhur me gjenerimin e mbeturinave janë treguar në tabelën e mëposhtme.

*Tabela 12.Sasia e mbeturinave komunale të grumbulluara dhe të gjeneruara në Suharekë,* [30]

| Komuna | Numri i banorëve (ASK-2011) | Numri i banorëve të shërbyer | Numri i ekonomive familjare (ASK-2011) | Numri i ekonomive familjare të shërbyera (2020) | Mbeturinat e përziera komunale të grumbulluara (ton/vit) | Mbeturinat e përziera komunale të grumbulluara (kg/vit) | Gjenerimi i mbeturinave për kokë banori (kg/vit) | Gjenerimi i mbeturinave për kokë banori (kg/ditë) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Suharekë** | **59,722** | **55,574** | **9,145** | **5,175** | **9,456.16** | **9,456,160.00** | **170.16** | **0.47** |

### 7.2.4. Deponitë e mbeturinave

Mbeturinat komunale nga territori i Suharekës deponohen në Deponinë Rajonale të Prizrenit (në Landovicë). Kjo deponi është ndërtuar në 2003 nga Këshilli Evropian (KE) dhe ka filluar të operojë në vitin 2004 ku kapaciteti total është 2,500,000 m$^3$. Në vitin 2020 janë regjistruar 105,305,18 tonë/vit dhe shkalla është rritur për 1.2% në krahasim me vitin paraprak[31]. Kjo deponi u shërben komunave të Prizrenit, Rahovecit, Malishevës, Suharekës, Dragashit, Mamushës dhe Gjakovës. Në këtë deponi, sistemi i pompimit të ujit nuk funksionon, ndërsa uji nga deponia dhe ujërat sipërfaqësore mund të përzihen, duke shkaktuar rrezik mjedisor. Kompresimi i mbeturinave nuk bëhet sipas standardeve. Kjo deponi ka qenë e paraparë të mbyllet në vitin 2020.[32]
Suhareka e ka **deponinë e mbetjeve bujqësore** në fshatin Shirokë [33]. Ndërsa gjithashtu e ka pas një **deponi të mbetjeve industriale** në lokacionin ish fabrikën për prodhimin e produkteve të gomës "Ballkani", që sipas autoriteteve komunale, është eleminuar në vitin 2019. **Deponia e mbeturinave ndërtimore dhe atyre nga demolimet** ndodhet në kuadër të zonës industriale në Suharekë, me sipërfaqe prej 39.156 m$^2$ dhe është në

[30] Raport i menaxhimit të mbeturinave komunale në Kosovë. Agjencia për mbrojtjen e mjedisit të Kosovës. Viti raportues 2020, (Shtojca 1)
[31] Raport i menaxhimit të mbeturinave komunale në Kosovë. Agjencia për mbrojtjen e mjedisit të Kosovës. Viti raportues 2020
[32]Plani Për Ndërhyrje Ndër-Sektoriale për Ndryshimet Klimatike për Prizrenin 2020-2025. Tetor 2019
[33]Plani Komunal për Menaxhimin e mbeturinave 2016-2021, Komuna e Suharekës, Janar 2016

pronësi të komunës. Çështja e manaxhimit të kësaj deponie do te rregullohet me një akt të veçantë.[34]

**Deponitë ilegale (pikat ilegale të grumbullimit të mbeturinave**) – bazuar në tabelën e mëposhtme, të dhënat tregojnë se në gjendjen në 2020 ka gjithsej 61 deponi ilegale.

*Tabela 13. Numri i deponive ilegale në Suharekë në vitin 2019/2020*[35]

| Komuna | Deponi të voga (1-5 thasë mbeturinash 200 litra) | Deponi të mesme (6-20 thasë mbeturinash 200 litra) | Deponi të mëdha (>20 thasë mbeturinash 200 litra) | Mbeturina komunale | Mbeturinat të ndërtimit dhe demolimit | Mbeturinat indust. dhe të rrezikshme | Mbeturinat të vëllimshme | Mbeturinat tjera | Deponi ilegale gjithsej (numri) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Suharekë** | **24** | **21** | **16** | **16.00 %** | **26.00 %** | **0.00 %** | **0.00 %** | **58.00 %** | **61** |

### 7.2.5. Ndarja e mbeturinave

Sipas të dhënave nga Raporti i AKMM, në Suharekë nuk ekziston infrastruktura për ndarjen e mbeturinave në burim.

*Tabela 14. Qasja në infrastrukturën për ndarjen e mbeturinave komunale në burim, në vitin 2019,* [36]

| Komuna | Numri i banorëve (ASK-2011) | Numri i ekonomive familjare (ASK-2011) | Numri i ekonomive familjare që ka qasje në infrastrukturën për ndarje në burim (2019) | Përqindja e ekonomive familjare ka qasje në infrastrukturën për ndarje në burim (2019) |
|---|---|---|---|---|
| **Suharekë** | **59722** | **9145** | **0.00** | **0.00 %** |

### 7.2.6. Zvogëlimi dhe riciklimi i mbeturinave

Nuk është gjetur ndonjë informatë për masa të caktuara që po zhvillon Komuna për zvogëlimin e mbeturinave, kompostimin, etj.Sipas të dhënave nga Komuna, Komuna e Suharekës ka filluar iniciativën për riciklim të mbeturinave dhe ka përgaditur projektin. Ky projekt nuk është implementuar, por Komuna ka në plan ta shtyj përpara këtë iniciativë.[37]

## 7.3. Ulja e Gazrave Serrë përmes masave të planifikuara dhe të propozuara në sektorin e menaxhimit të mbeturinave

Masat e planifikuara për sektorin e Menaxhimit të mbeturinave, në këtë plan, përfshijnë 5 objektiva me masat përkatëse. Objektivat janë:

- Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të mbeturinave dhe ri-shikimi/përpilimi i legjislacionit përkatës
- Ulja e sasisë së mbeturinave të gjeneruara
- Promovimi i riciklimit dhe ripërdorimit të mbeturinave
- Ulja e GS përmes ndalimittë hedhjes ilegale të mbeturinave
- Ulja e emetimit të GS nga deponitë ilegale (pikat ilegale të grumbullimit të mbeturinave).

Ulja e emetimeve të GS nga masat e ndërmarra në sektorin e mbeturinave, duhet të përcaktohet gjatë përpilimit të paramasave teknike për zbatimin e masave (projekteve) të caktuara sipas këtij plani.

[34]Plani Komunal për Menaxhimin e mbeturinave 2016-2021, Komuna e Suharekës, Janar 2016

[35]Raport i menaxhimit të mbeturinave komunale në Kosovë. Agjencia për mbrojtjen e mjedisit të Kosovës. Viti raportues 2020.

[36] Raport i menaxhimit të mbeturinave komunale në Kosovë. Agjencia për mbrojtjen e mjedisit të Kosovës. Viti raportues 2020.

[37]Skema e projektit teknologjik të impiantit për kompostim bioreaktor dhe prodhim të eko-kompostit. Komuna e Suharekës

## 7.4. Plani i masave për sektorin e mbeturinave

| Sektori: Menaxhimi i mbeturinave | | Indikatorët e suksesit | Institucioni përgjegjës | Sektorët e ndërlidhur | Afati kohorë | Kostoja financiare | Burimi i financimit | Ulja e $CO_2$ (ton/vit) | Statusi | Projekt /Plani Sektorial | Prioriteti |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Objektivi 7.1: Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të mbeturinave dhe ri-shikimi/përpilimi i legjislacionit përkatës** | | | | | | | | | | | |
| **Masa 7.1.1: Rishikimi i sistemit të menaxhimit të mbeturinave** | | | | | | | | | | | |
| 7.1.1.1 | Finalizimi dhe aprovimi i Planit Komunal për Menaxhim të Mbeturinave (PKMM) | – Dokumenti i Planit të veprimit | – Drejtoria për Shërbime publike, mjedis dhe mergjencë | – Ekoregjioni<br>– Sektori privat<br>– Shoqëria civile<br>– Donatorët | 2022-2023 | 20,000.00 | – Buxheti komunal<br>– Qeveria e Kosovës<br>– Donatorët | | | Në proces | |
| 7.1.1.2 | Krijimi i sistemit të qëndrueshëm për menaxhimin e mbeturinave të ngurrta komunale. Ky sistem të bazohet në konceptin 3R:<br>– Reduktimin (Parandalim),<br>– Ri-përdorimin, dhe<br>– Ri-ciklimin e mbeturinave | – Sasia e mbeturinave të ri-përdorura dhe të ri-cikluara | – Drejtoria për Shërbime publike, mjedis dhe mergjencë | – Ekoregjioni<br>– Sektori privat<br>– Shoqëria civile<br>– Donatorët<br>– Drejtoria e inspeksionit | 2023-2030 | 600,000.00 | – Buxheti komunal<br>– Qeveria e Kosovës<br>– Donatorët | | | Propozim i ri | |
| | | | | | | **620,000.00** | | | | | |
| **Masa 7.1.2: Rishikimi i Rregullores për menaxhimin e mbeturinave në territorin e Suharekës** | | | | | | | | | | | |
| 7.1.2.1 | Rishikimi i Rregullores për menaxhimin e mbeturinave në territorin e Suharekës, bazuar në PKMM të finalizuar. Rregullorja të trajtojë edhe aspekte tjera, sikur që janë:<br>– Ripërdorimi i mbeturinave (reduktimin e mbeturinave),<br>– Rregullimin e përdorimit të qeseve të plastikës, (psh. vendosjen e çmimit në qeset e plastikës që ofrohen nga dyqanet dhe shitësit)<br>– Trajtimi i mbetjeve organike<br>– Kompostmin e mbeturinave organike bimore | – Sasia e mbeturinave të ri-përdorura dhe të ri-cikluara | – Drejtoria për Shërbime publike, mjedis dhe mergjencë | – Ekoregjioni<br>– Sektori privat<br>– Shoqëria civile<br>– Donatorët<br>– Drejtoria e inspeksionit | 2023-2024 | 15,000.00 | – Buxheti komunal<br>– Qeveria e Kosovës<br>– Donatorët | | | Propozim i ri | |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Masa 7.1.3: Rritja e efikasitetit për grumbullimin e mbeturinave** | | | | | | | | | | | |
| 7.1.3.1 | Studimi për pikat e ekzistuese të kontejnerëve në qytet dhe fshatra, analizimi i funksional dhe rekomandimet për qasje më të lehtë në to, si dhe identifikimi i pikave të reja të mundshme për vendosjen e kontejnerëve. | – Raporti i studimit me rekomandimet | – Drejtoria për Shërbime publike, mjedis dhe mergjencë | – Ekoregjioni<br>– Sektori privat<br>– Shoqëria civile<br>– Drejtoria e inspeksionit | 2023-2024 | 5,000.00 | – Buxheti komunal | | | Propozim i ri | |
| | | | | | | **15,000.00** | | | | | |
| **Objektivi 7.2. Ulja e sasisë së mbeturinave të gjeneruara** | | | | | | | | | | | |
| **Masa 7.2.1: Rritja e kompostimit të mbeturinave organike** | | | | | | | | | | | |
| 7.2.1.1 | Zhvillimi i Planit për kompostimin e mbetjeve organike bimore. Plani i kompostimit do të përfshijë analizën në lidhje me palët/personat që do të përfitonin më së shumti nga shpërndarja e kompostuesve. Analiza do të përfshijë edhe sasinë e mbetjeve të rrushit, kungullit, pemëve dhe perimeve që mund të kompostohen. | – Dokumenti i Planit për kompostim | – Drejtoria për Shërbime publike, mjedis dhe mergjencë | – Ekoregjioni<br>– Drejtoria për bujqësi, zhvillim rural dhe pylltari<br>– Sektori privat | 2023-2024 | 10,000.00 | – Buxheti komunal | - | - | Propozim i ri | |
| 7.2.1.2 | Furnizimi dhe shpërndarja e kompostuesve për kompostim të mbeturinave organike bimore | – Numri i kompostuesve të shpërndarë dhe përdorimi i tyre | – Drejtoria për Shërbime publike, mjedis dhe mergjencë | – Ekoregjioni<br>– Drejtoria për bujqësi, zhvillim rural dhe pylltari<br>– Sektori privat | 2024-2026 | 70,000.00 | – Buxheti komunal,<br>– Qeveria,<br>– Donatorët | - | - | Propozim i ri | |
| 7.2.1.3 | Zhvillimi dhe organizimi i fushatës vetëdijësuese dhe informuese të qytetarët për rëndësinë e uljes së mbeturinave, përfshirë mbeturinat organike, për mënyrën e shfrytëzimit të kompostuesve, si dhe për përfitimet nga kompostimi. | – Sasia e mbeturinave organike të mbledhura | – Drejtoria për Shërbime publike, mjedis dhe mergjencë | – Ekoregjioni<br>– Drejtoria për bujqësi, zhvillim rural dhe pylltari<br>– Sektori privat | 2023-2024 | 10,000.00 | – Buxheti komunal | - | - | Propozim i ri | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
